



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A.  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës më 08.09.2026

**PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE  
FSHATRAVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE FUSHE KUQE DHE THUMANE,  
BASHKIA KURBIN DHE BASHKIA KRUJE**

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 24 Muaj**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
45247130-0 Punime ndërtimi për ujësjellës

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,238,635,422 (një miliard e dyqind e tridhjetë e tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e dy) lek pa tvsh.

**Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 13.453.192,37** (Trembedhjetë milion e katerqind e pesedhjetë e tre mije e njeqind e nentedhjetë e dy presje tridhjetë e shtate) **Euro.**

**Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 08.09.2026 është 92.07 euro.**

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për 3 vite 2027-2029

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjedhjes së fituesit ka përgjedhur si më poshtë:

**A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

**Çmimi** ☐

**pikët 50**

**Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit** □ □

**pikët 20**

**Stafi / Organizimi i Kompanise** □ □

**pikët 15**

**Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** □ □

**pikët 10**

**Periudha e garancisë së objektit** □ □

**pikët 5**

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto**

### **Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

#### **1. Çmimi [50] pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$  Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

#### **2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]**

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 24 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

\*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

$P_{k2a}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$  Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k2a}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

### 3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

\*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve me poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të vecante të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënes të mëparshëm ose përfituesit.

b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

\*Shenim: Per permbushjen e kriterit te mesiperm operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

#### 4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

#### 5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

$P_{k5}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$  Vlera e më e larte e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k5}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

#### Argumentim:

*Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

*Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

*Kritere të tilla mund të përfshihen:*

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;
- b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose
- c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

*Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:*

- a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose
- b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

*Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këto kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin suksess të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.*

*Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragjitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.*

*Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi/ Organizimi Kompanisë, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetëm një staf kualifikuar profesional inxhinier - teknik dhe me përvojën e duhur mund të sielle rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventiv të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të deshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.*

*Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.*

*Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që në veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht*

*Duke patur parasysh se përveç realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet të kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.*

*Per të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.*

*Nënkriteret për operatorët ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:*

*Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migrues me miedisin të ricikluara/ eficient/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësim të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.*

*Një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe periudhës së garancisë së objektit të cila tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa me maksimale të jetë periudha që përfshin garancinë e veprës e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.*

*Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Për Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, njësisë e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria*

Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Durrës sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

□

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:**

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kriteret e veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2, Shtojca 7 e DST-së.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të veçanta të Kualifikimit, të shtojcës 7 e DST-së;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.2.3/b, 2.2.3/c, 2.2.3/d, 2.3.4 të kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 7 e DST-së.
- Staf i Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3/c, 2.3.3/d, 2.3.3/g, të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7 e DST-se.

**Argumentim:** Në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë natyrën, objektin, volumin, kompleksitetin teknik dhe kohëzgjatjen e kontratës, si dhe nevojën për të garantuar që operatori ekonomik i kualifikuar të disponojë kapacitetet e nevojshme ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të saj.

Kriteret e përcaktuara në Shtojcën 7 të DST-së janë vendosur në funksion të verifikimit të aftësisë reale të operatorëve ekonomikë për marrjen përsipër dhe realizimin e kontratës, duke synuar njëkohësisht proporcionalitetin e kërkesave me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit.

### 1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar – pikat 2.2.1 dhe 2.2.2 të Shtojcës 7 të DST-së

Kërkesat e përcaktuara në pikat 2.2.1 dhe 2.2.2 janë vendosur me qëllim verifikimin e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit ekonomik e financiar të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Realizimi i kontratës kërkon angazhimin e vazhdueshëm të burimeve financiare për sigurimin e fuqisë punëtore, mjeteve dhe makinerive, materialeve, pajisjeve, furnizimeve dhe shpenzimeve të tjera të domosdoshme për ekzekutimin e punimeve.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor duhet të krijojë bindjen e arsyeshme se operatori ekonomik disponon një kapacitet financiar të përshtatshëm për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës dhe për të siguruar vijueshmërinë e punimeve pa krijuar ndërprerje për shkak të pamundësisë financiare.

*Kërkesat për xhiron dhe dokumentacionin financiar nuk synojnë kufizimin e konkurrencës, por shërbejnë si tregues objektivë të aktivitetit ekonomik dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit në raport me përmasat e kontratës që do të marrë përsipër.*

*Në këtë kuptim, kriteret e pikave 2.2.1 dhe 2.2.2 janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe vlerën e kontratës dhe synojnë reduktimin e riskut të mosrealizimit apo të ndërprerjes së kontratës për shkak të mungesës së kapaciteteve të nevojshme financiare.*

## *2. Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme – pika 2.3.1 e Shtojcës 7 të DST-së*

*Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1, lidhur me realizimin me sukses të kontratave të mëparshme, është vendosur për të provuar eksperiencën reale teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik në realizimin e punimeve të një natyre të njëjtë ose të ngjashme me objektin e prokurimit.*

*Përvoja e mëparshme përbën një element të rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë së operatorit ekonomik për të organizuar dhe menaxhuar realizimin e kontratës, për të koordinuar burimet njerëzore dhe teknike dhe për të përballuar problematikat që mund të lindin gjatë ekzekutimit.*

*Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e objektit të prokurimit dhe ndërthurjen e disa kategorive të punimeve, eksperiencën në kontrata të mëparshme krijon një garanci të arsyeshme se operatori ekonomik ka realizuar më parë procese pune të krahasueshme dhe disponon njohuritë organizative dhe teknike të nevojshme.*

*Kriteri nuk synon thjesht evidentimin e ekzistencës formale të kontratave të mëparshme, por provimin se operatori ekonomik ka qenë në gjendje t'i realizojë ato me sukses.*

*Për rrjedhojë, kërkesa për përvojën e suksesshme është e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të kontratës dhe është vendosur për të garantuar një nivel të përshtatshëm sigurie lidhur me aftësinë e operatorit për realizimin cilësor dhe brenda afateve të kontratës objekt prokurimi.*

## *3. Licencat profesionale – pika 2.3.2/a e Shtojcës 7 të DST-së*

*Kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2/a për disponimin e licencave profesionale përkatëse është vendosur në përputhje me natyrën dhe kategoritë e punimeve që parashikohen të realizohen në kuadër të kontratës.*

*Licencimi profesional përbën provën se operatori ekonomik është i kualifikuar për ushtrimin e veprimtarisë dhe realizimin e kategorive përkatëse të punimeve, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*

*Kategoritë dhe klasifikimet e licencës të kërkuara në DST janë përcaktuar duke u nisur nga zërat konkretë të preventivit, specifikimet teknike dhe natyra e punimeve që duhet të realizohen dhe, për rrjedhojë, nuk përbëjnë kërkesa të shkëputura nga objekti i kontratës.*

*Qëllimi i këtij kriteri është që realizimi i punimeve t'i besohet një operatori që disponon aftësinë dhe kualifikimin profesional të nevojshëm për kategoritë konkrete të punimeve, duke garantuar respektimin e standardeve teknike, cilësisë së zbatimit dhe kërkesave të sigurisë.*

*Për këtë arsye, kërkesa për licencat duhet të konsiderohet e domosdoshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, ndërsa kategoritë dhe nivelet përkatëse duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe vlerën e punimeve që mbulon secila kategori.*

*4. Staf i teknik – pikat 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3/c, 2.3.3/d, 2.3.3/e, 2.3.3/f, 2.3.3/g dhe 2.3.3/h të Shtojcës 7 të DST-së*

*Kërkesat lidhur me stafin teknik dhe profesional janë përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, volumnin, kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e proceseve të punës që parashikohen në preventiv dhe specifikimet teknike.*

*Realizimi i objektit të kontratës kërkon jo vetëm disponimin e mjeteve dhe makinerive të përshtatshme, por edhe angazhimin e personelit me formimin, eksperiencën dhe kualifikimet profesionale përkatëse.*

*Në këtë kuadër, kërkesat e pikave 2.3.3/a–2.3.3/h synojnë të provojnë se operatori ekonomik disponon një strukturë të përshtatshme teknike dhe organizative për realizimin e njëkohshëm dhe të koordinuar të proceseve të ndryshme të punës.*

*Stafi inxhinierik dhe teknik është i domosdoshëm për drejtimin teknik të punimeve, kontrollin e zbatimit të projektit, respektimin e specifikimeve teknike, organizimin e kantierit, kontrollin e cilësisë, matjet dhe verifikimet, koordinimin e proceseve të punës dhe respektimin e kërkesave të sigurisë.*

*Po kështu, personeli i specializuar dhe punonjësit e kualifikuar janë të nevojshëm për realizimin praktik të zërave specifike të preventivit, përfshirë punimet e ndërtimit, punimet hidroteknike, montimin dhe testimin e tubacioneve, punimet elektrike, mekanike, topografike, betonimin, armimin, asfaltimin dhe proceset e tjera që parashikohen në objekt.*

*Numri dhe profilet e personelit të kërkuar duhet të vlerësohen në raport me volumnin e punimeve, grafikun e realizimit, shtrirjen e kantierit dhe nevojën për zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës.*

*Për rrjedhojë, kërkesat për stafin teknik nuk janë vendosur thjesht për të provuar numrin e të punësuarve të operatorit ekonomik, por për të garantuar disponueshmërinë reale të burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës.*

*Këto kritere krijojnë siguri për Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik do të jetë në gjendje të realizojë punimet sipas projektit, preventivit, specifikimeve teknike dhe grafikut të punimeve, pa cenuar cilësinë, afatet dhe sigurinë gjatë zbatimit.*

#### **Argumentimi për mosndarjen në lote:**

*Në mbështetje të nenit 39 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti/Enti Kontraktor, pas analizimit të natyrës, objektit, ndërvarësisë teknike dhe funksionale të punimeve, ka vlerësuar që procedura me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të Njësisë Administrative Fushë-Kuqe – Thumanë, Bashkitë Kurbin dhe Krujë” të zhvillohet si një kontratë e vetme dhe të mos ndahet në lote.*

Objekti i kontratës përbën një sistem të vetëm dhe të integruar të furnizimit me ujë, i cili përfshin linjën e dërgimit, ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>, linjat kryesore të rrjetit të ujësjellësit të Fushë-Kuqes, Thumanës dhe Gramëzit, rrjetet shpërndarëse në zonat përkatëse, pusetat dhe pajisjet hidraulike, instalimet elektrike dhe sistemet e kontrollit, si dhe rikthimin e shtresave rrugore të prekura nga punimet. Preventivi i objektit i paraqet këto komponentë si pjesë të të njëjtit investim dhe të të njëjtit sistem funksional.

Nënobjektet kanë varësi të drejtpërdrejtë hidraulike dhe teknologjike ndërmjet tyre. Linja e dërgimit lidhet me depon 2,000 m<sup>3</sup>, depoja lidhet me linjat kryesore dhe këto të fundit furnizojnë rrjetet shpërndarëse. Për rrjedhojë, funksionimi dhe marrja në dorëzim e një komponenti kushtëzohen nga përfundimi dhe përpunshmëria teknike e komponentëve të tjerë. Ndarja e tyre në kontrata të veçanta do të krijonte ndërfaqe të shumta teknike ndërmjet kontraktorëve dhe do të rriste rrezikun e mospërpunjeve në kuota, lidhje, presione, rakorderi, testime dhe vënie në funksion të sistemit.

Preventivi parashikon gjithashtu një zinxhir të integruar punimesh, duke filluar nga gërmimet dhe përgatitja e traseve, vendosja e tubacioneve dhe rakorderive, realizimi i strukturave betonarme, mbushja dhe ngjeshja e kanaleve, deri te rikthimi i stabilizantit, binderit dhe asfaltobetonit. Për shembull, vetëm në linjën kryesore të Fushë-Kuqes parashikohen 11,378.80 m<sup>3</sup> gërmim mekanik kanali, 7,781.20 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll e gur gurore dhe mijëra metra katrorë shtresa stabilizanti. Në linjën kryesore të Gramëzit parashikohen gjithashtu mbushje, stabilizant, binder, asfaltobeton dhe punime betonarmeje.

Ndarja e këtyre proceseve apo nënobjekteve në kontrata të ndryshme do të krijonte varësi kontraktuale, pasi një kontraktor nuk do të mund të përfundonte punimet e tij pa realizimin e punimeve të kontraktorit tjetër. Kjo do të rriste rrezikun e vonësive, pretendimeve reciproke për përgjegjësi, kostove shtesë të koordinimit dhe vështirësive në përcaktimin e përgjegjësisë për defektet gjatë testimit dhe periudhës së garancisë.

Gjithashtu, objekti përfshin elemente hidraulike, elektrike dhe elektronike që duhet të integrohen në të njëjtin sistem, përfshirë pajisjet e kontrollit dhe RTU-në për komunikimin me sistemin ekzistues SCADA. Për këtë arsye është e nevojshme që përgjegjësia për instalimin, integrimin, testimin dhe vënien në punë të sistemit të jetë e unifikuar dhe e identifikueshme te një kontraktor i vetëm.

Mosndarja në lote mundëson gjithashtu hartimin dhe zbatimin e një grafiku unik të punimeve, organizimin e fronteve paralele, përdorimin e koordinuar të makinerive dhe personelit, furnizimin e unifikuar me materiale dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë. Në të kundërt, kontraktimi i veçantë i linjës së dërgimit, depos, linjave kryesore dhe rrjeteve shpërndarëse do ta kushtëzonte progresin e secilit kontraktor nga realizimi i kontratave të tjera dhe do të shtonte rrezikun e mosrespektimit të afatit të përgjithshëm të investimit.

Ky vlerësim është në përpunje edhe me qëllimet e ligjit nr. 162/2020 për rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të prokurimit, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e kostove procedurale, duke ruajtur njëkohësisht konkurrencën, trajtimin e barabartë, proporcionalitetin dhe transparencën.

Për më tepër, natyra e objektit lidhet drejtpërdrejt me sektorin e ujit, për të cilin neni 62 i ligjit nr. 162/2020 përfshin ofrimin ose përdorimin e rrjeteve për prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. Në çdo rast, pavarësisht regjimit procedural që zbatohet për kontratën

sektoriale, Autoriteti/Enti Kontraktor ka kryer këtë analizë për të dokumentuar se mosndarja nuk synon kufizimin artificial të konkurrencës, por buron nga uniteti teknik dhe funksional i veprës, ndërvarësia e nënobjekteve dhe nevoja për përgjegjësi të vetme për performancën përfundimtare të sistemit.

Në aspektin e zbatimit të punimeve, është marrë në konsideratë edhe VKM nr. 448, datë 31.07.2025, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, e cila rregullon organizimin dhe funksionimin e kantierit dhe përgjegjësitë e aktorëve të zbatimit. Organizimi i integruar i këtij investimi nën një kontratë të vetme mundëson përcaktim më të qartë të përgjegjësisë së zbatuesit, koordinim më efektiv me drejtuesin teknik dhe mbikëqyrësin, menaxhim të unifikuar të kantierit dhe kontroll më efektiv të zbatimit të projektit.

Për sa më sipër, Autoriteti/Enti Kontraktor vlerëson se ndarja e kësaj procedure në lote nuk është teknikisht dhe funksionalisht e përshtatshme dhe nuk do t’i shërbente realizimit eficient të objektit. Zhvillimi i procedurës si një kontratë e vetme garanton koordinim të plotë të punimeve, përgjegjësi të unifikuar për cilësinë dhe funksionimin e sistemit, respektimin e grafikut të punimeve dhe reduktimin e rreziqeve teknike, kontraktuale dhe administrative gjatë zbatimit.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.2.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**2.2.3.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2026 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;** ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore

minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare<sup>1</sup>. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në keto kushte, vlerësojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizës së Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë

pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### **Ose**

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:**

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

*Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.*

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

*Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në

projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”* (i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM te dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

### 2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- |                                                                                         |                      |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| • <b>Kategoria NP- 1</b> Punime gjurmimi në tokë                                        | <b>Klasifikimi</b> C |
| • <b>Kategoria NP- 4</b> Rruge, autostrada, ura, mbikalime...                           | <b>Klasifikimi</b> B |
| • <b>Kategoria NP- 7</b> Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje | <b>Klasifikimi</b> G |
| • <b>Kategoria NP-12</b> Punime të inxhinierisë së mjedisit                             | <b>Klasifikimi</b> C |
| • <b>Kategoria NS-14</b> Impiante te brendshme elektrike telefonike etj...              | <b>Klasifikimi</b> A |
| • <b>Kategoria NS-18</b> Punime topogjeodezike                                          | <b>Klasifikimi</b> D |
| • <b>Kategoria NS-20</b> Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë            | <b>Klasifikimi</b> A |

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

**Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:**

Kategoritë dhe klasifikimet e licencës profesionale të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor janë përcaktuar duke u mbështetur në natyrën e objektit të prokurimit, zërat e preventivit, volumet e punimeve, vlerat përkatëse të tyre, kompleksitetin teknik dhe shtrirjen territoriale të ndërhyrjeve.

Objekti “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njesisë Administrative Fushë-Kuqe dhe Thumanë, Bashkitë Kurbini dhe Krujë” përfshin një ndërthurje të punimeve hidroteknike me punime gjurmimi, rikonstruksion të shtresave rrugore, ndërtim të strukturave të ujësjellësit, punime mjedisore, elektrike dhe automatizimi, punime topogjeodezike, si dhe ndërhyrje të specializuara të lidhura me burimet ujore.

Për këtë arsye, kategoritë e mëposhtme janë të nevojshme për realizimin e plotë dhe teknikisht korrekt të objektit.

**1. Kategoria NP-1 – Punime gjurmimi në tokë – Klasifikimi C**

Kërkesa për kategorinë NP-1, Klasifikimi C, argumentohet nga volumi i konsiderueshëm i punimeve të dheut dhe gjurmimeve që shoqërojnë ndërtimin e linjave kryesore dhe të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, ndërtimin e pusëve, depoz dhe strukturave të tjera të parashikuara në projekt.

Preventivi përmban në mënyrë të përsëritur zëra të tillë si: gjurmim kanalesh në tokë të zakonshme dhe të fortë; gjurmim dheu me ekskavator në kanale; gjurmime për vendosjen e tubacioneve; mbushje, rrafshim dhe ngjeshje; transport të materialeve dhe dherave; mbushje me çakëll dhe gur gurorë.

Volumet janë të konsiderueshme dhe përsëriten në të gjitha zonat e ndërhyrjes. Vetëm në një nga nënobjektet e preventivit evidentohet transporti i 14,323.52 m<sup>3</sup> dhe, ndërsa në një nënobjekt tjetër 14,517.74 m<sup>3</sup>. Po kështu, për ndërtimin e depoz së re 2,000 m<sup>3</sup> parashikohen 13,710 m<sup>3</sup> gjurmim mekanik në kanale dhe 230 m<sup>3</sup> gjurmim manual në tokë të fortë. Për rrjedhojë, gjurmimet nuk janë punime sporadike apo ndihmëse, por përbëjnë një proces të vazhdueshëm dhe me volum të konsiderueshëm në të gjithë objektin. Kategoria NP-1 dhe klasifikimi i kërkuar justifikohen nga volumi i gjurmimeve, shtrirja e tyre në disa fronte pune dhe nevoja për realizimin e tyre me mjete të mekanizuara dhe personel të specializuar.

**2. Kategoria NP-4 – Rrugë, autostrada, ura, mbikalime etj. – Klasifikimi B**

Kategoria NP-4, Klasifikimi B, është e lidhur me ndërhyrjet që duhet të kryhen në infrastrukturën rrugore gjatë hapjes dhe rikthimit të traseve të tubacioneve.

Vendosja e rrjetit të ujësjellësit kërkon ndërhyrje në rrugë dhe sipërfaqe ekzistuese dhe, pas instalimit të tubacioneve, rikthimin e tyre në gjendjen e kërkuar teknike.

Preventivi përmban volume të konsiderueshme të: mbushjes me çakëll dhe gur gurorë në trupin e rrugës; shtresave të stabilizantit; shtresave të binderit; asfaltobetonit; prerjes së asfaltit dhe betonit; shtresave të betonit; bordurave dhe trotuareve.

Vetëm për linjën kryesore të Gramëz parashikohen 4,085.30 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll/gur gurore, 2,960.10 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm, 2,340 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm, si dhe 2,919 m<sup>2</sup> binder dhe 2,919 m<sup>2</sup> asfaltobeton. Këto volume provojnë se objekti nuk kufizohet vetëm në instalimin e tubacioneve, por përmban edhe një komponent të rëndësishëm të rikonstruksionit të shtresave rrugore.

Për rrjedhojë, kërkesa për NP-4, Klasifikimi B, është e lidhur drejtpërdrejt me zërat dhe volumet e preventivit dhe synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin profesional për rikthimin teknikisht korrekt të infrastrukturës rrugore të prekur nga punimet.

3. Kategoria NP-7 – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje – Klasifikimi G  
Kategoria NP-7 përbën kategorinë kryesore dhe thelbësore të objektit të prokurimit.

Vetë objekti konsiston në rikonstruksionin dhe zgjerimin e një sistemi ujësjellësi në një territor të gjerë, duke përfshirë: linjën e dërgimit; linjat kryesore të shpërndarjes; linjat sekondare të rrjetit shpërndarës; ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>; tubacione PE100 RC me diametra të ndryshëm; tubacione çeliku dhe gize; rakorderi; saraçineska dhe valvula; matësa uji; puseta kontrolli dhe komandimi; sisteme të reduktimit dhe kontrollit të presionit; elemente të kullimit; sistemin e monitorimit dhe komandimit të rrjetit.

Rëndësia e kësaj kategorie evidentohet edhe nga vlerat e nënobjekteve. Vetëm linjat kryesore të rrjetit shpërndarës për Fushë-Kuqe, Thumanë dhe Gramëz kanë respektivisht vlera rreth 206.48 milionë lekë, 103.32 milionë lekë dhe 74.03 milionë lekë, ndërsa linjat shpërndarëse në fshatrat e tjerë përbëjnë disa qindra milionë lekë të tjera.

Për rrjedhojë, NP-7 është kategoria dominante e kontratës dhe Klasifikimi G argumentohet nga vlera shumë e lartë, volumi dhe shtrirja e punimeve hidroteknike, si dhe nga fakti se pjesa kryesore e kontratës konsiston pikërisht në ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit.

4. Kategoria NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit – Klasifikimi C

Kërkesa për NP-12, Klasifikimi C, lidhet me natyrën e objektit si një ndërhyrje infrastrukturore me shtrirje të gjerë territoriale dhe me domosdoshmërinë e rehabilitimit dhe sistemimit të zonave të prekura nga punimet. Preventivi përmban punime të sistemimit dhe rehabilitimit të territorit, përfshirë mbjelljen e barit në skarpate dhe vendosjen e shkurreve dekorative. Në zonën e depos, konkretisht, janë parashikuar 600 m<sup>2</sup> mbjellje bari në skarpate dhe 120 copë shkurre dekorative.

Gjithashtu, realizimi i rrjetit përfshin menaxhimin e volumeve të konsiderueshme të dherave, rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura, sistemimin e skarpateve dhe rikthimin e territorit pas përfundimit të ndërhyrjeve. Kërkesa për këtë kategori duhet parë në raport me tërësinë e ndërhyrjeve mjedisore të objektit dhe me nevojën që punimet të realizohen duke garantuar rehabilitimin e zonave të prekura dhe minimizimin e ndikimit të punimeve në mjedis.

5. Kategoria NS-14 – Impiante të brendshme elektrike, telefonike etj. – Klasifikimi A- Kërkesa për NS-14, Klasifikimi A, është e lidhur drejtpërdrejt me instalimet elektrike dhe sistemet e komandimit që parashikohen në preventiv.

Në objekt përfshihen ndër të tjera:ndriçues;përcjellës dhe kablllo elektrike;elektroda dhe sistem tokëzimi;shtylla ndriçimi;kuadro elektrike dhe komandimi;sistem rrufepritës;kablllo kontrolli;pajisje elektronike RTU;pajisje për komunikimin në distancë;sistem monitorimi me kamera;integrimi me sistemin SCADA.

Në preventivin e depos, ndër të tjera, parashikohen 560 ml linjë kablllore bakri 5x6 mm<sup>2</sup>, kuadër elektrik, sistem tokëzimi, pajisje RTU për komunikim me SCADA-n ekzistuese dhe elemente të tjera elektrike dhe elektronike.

Për rrjedhojë, kërkesa për NS-14 është e argumentuar nga ekzistenca reale e instalimeve elektrike dhe sistemeve të komandimit, ndërsa Klasifikimi A është në përputhje me peshën përkatëse të këtyre punimeve në raport me objektin e përgjithshëm.

#### 6. Kategoria NS-18 – Punime topogjeodezike – Klasifikimi D

Kategoria NS-18, Klasifikimi D, është e domosdoshme për shkak të shtrirjes së konsiderueshme territoriale të objektit dhe numrit të madh të linjave që duhet të zbatohen.

Punimet topogjeodezike janë të lidhura në mënyrë funksionale me:piketimin e akseve të tubacioneve;përcaktimin e kuotave të projektit;kontrollin e niveleve dhe pjerrësive;pozicionimin e pusetave dhe elementeve të rrjetit;rilevimet gjatë zbatimit;kontrollin gjeometrik të punimeve; hartimin e dokumentacionit faktik/as-built pas realizimit.

Objekti nuk zhvillohet në një kantier të vetëm, por përfshin linja kryesore dhe shpërndarëse në Fushë-Kuqe, Thumanë, Gramëz, Patok, Gorre, Adriatik, Dukagjin i Ri, Bushnesh, Sukth Vendas dhe zona të tjera të evidentuara në preventiv.

Pikërisht kjo shtrirje territoriale dhe numri i madh i fronteve të punës, së bashku me domosdoshmërinë për respektimin e kuotave dhe koordinatave të projektit për një rrjet ujësjellësi, argumentojnë kërkesën për kapacitet profesional të posaçëm në punimet topogjeodezike.

#### 7. Kategoria NS-20 – Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë – Klasifikimi A

Kërkesa për NS-20, Klasifikimi A, lidhet me punimet e specializuara që kanë të bëjnë me shpimet, puset dhe ndërhyrjet që lidhen me burimet nëntokësore të ujit, sipas zërave përkatës të projektit dhe preventivit.

Kjo kategori ka karakter specifik dhe kërkon mjete, pajisje dhe eksperiencë profesionale të posaçme, të ndryshme nga punimet e zakonshme të ndërtimit të rrjetit.

Përcaktimi në Klasifikimin A reflekton faktin se këto punime, ndonëse teknikisht të specializuara dhe të domosdoshme për pjesën përkatëse të objektit, nuk përbëjnë komponentin me vlerën dominuese të kontratës, sikurse ndodh me punimet e kategorisë NP-7.

#### b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë SSH EN ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë SSH EN ISO 14001-2026 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë SSH EN ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Cerifikatë ISO 45001-2023, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatën SSH EN ISO 3834-2: 2021 Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, ky standart lidhet me sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë së procesit të saldimit, ose ekuivalente me të, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje*

me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për te vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

#### *Certifikatë SSH EN ISO 9001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë”*

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 9001:2015, ose ekuivalente, argumentohet nga kompleksiteti, volumi dhe shumëllojshmëria e proceseve që përmban objekti i kontratës. Punimet nuk konsistojnë në një proces të vetëm ndërtimor, por përfshijnë ndërtimin dhe rikonstruksionin e linjave të ujësjellësit, punime gërmimi dhe mbushjeje, vendosje tubacionesh dhe rakorderish, ndërtim të strukturave betonarme, rikonstruksion të shtresave rrugore, instalime elektrike dhe automatizimi, si dhe pajisje matëse e kontrolli.

Preventivi parashikon volume të konsiderueshme të tubacioneve PE100 RC me diametra të ndryshëm; për shembull, vetëm në linjën e Gramëzit evidentohen 1,186 ml tub PE100 RC DN125, 1,402 ml DN140 dhe 410 ml DN160. Po kështu, përmban punime të konsiderueshme në shtresat rrugore, si 4,085.30 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll, 2,960.10 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm, 2,340 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm dhe 2,919 m<sup>2</sup> shtresa binder/asfaltobeton vetëm për linjën kryesore të Gramëzit.

Në këto kushte, zbatimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë është i nevojshëm për të garantuar kontrollin e materialeve hyrëse, gjurmueshmërinë e produkteve, kontrollin e proceseve të zbatimit, inspektimet dhe testimet, menaxhimin e mospërputhjeve dhe dokumentimin e cilësisë gjatë gjithë realizimit të kontratës.

Për rrjedhojë, kërkesa për ISO 9001:2015 është në përputhje me objektin dhe synon të krijojë siguri se operatori ekonomik aplikon procedura të standardizuara për garantimin e cilësisë së punimeve dhe të materialeve/pajisjeve që do të instalohen.

#### *Certifikatë SSH EN ISO 14001:2026 – “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit”*

Kërkesa për SSH EN ISO 14001:2026, ose ekuivalente, argumentohet nga ndikimi që realizimi i këtij objekti mund të ketë mbi mjedisin për shkak të gërmimeve masive, transportit të dherave, përdorimit të makinerive të rënda, ndërhyrjeve në territor dhe rikthimit të sipërfaqeve pas përfundimit të punimeve.

Preventivi përmban volume të konsiderueshme të punimeve të dheut. Në nënobjekte të ndryshme evidentohen, ndër të tjera, transporti i 14,323.52 m<sup>3</sup> material/dhe dhe transporti i 14,517.74 m<sup>3</sup> material/dhe. Për ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup> parashikohen gjithashtu 13,710 m<sup>3</sup> gërmime mekanike në kanale dhe 230 m<sup>3</sup> gërmime në tokë të fortë.

Punime të kësaj natyre gjenerojnë dhera dhe materiale të tepërta, pluhur, zhurmë, lëvizje të mjeteve të rënda dhe nevojë për administrimin e sipërfaqeve të prekura. Preventivi parashikon edhe ndërhyrje rehabilituese të territorit, si 600 m<sup>2</sup> mbjellje bari në skarpate.

*Për rrjedhojë, sistemi ISO 14001:2026 është i lidhur me nevojën për identifikimin dhe kontrollin e aspekteve mjedisore gjatë realizimit të kontratës, menaxhimin e mbetjeve dhe dherave të dala nga gërmimet, reduktimin e ndotjes, kontrollin e pluhurave dhe zhurmave, si dhe rehabilitimin e zonave të prekura.*

*Certifikatë SSH EN ISO 45001:2018 / ISO 45001:2023 – “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”*

*Kërkesa për ISO 45001 argumentohet drejtpërdrejt nga niveli i riskut që paraqesin punimet e parashikuara në preventiv.*

*Realizimi i kontratës kërkon punime gërmimi në kanale, përdorim ekskavatorësh dhe makinerish të rënda, transport materialesh, punime me betonarme, punime në instalime elektrike, montim elementesh metalike, vendosje tubacionesh dhe rakorderish, si dhe procese që realizohen në fronte të ndryshme pune.*

*Vetëm për linjën kryesore Fushë-Kuqe, preventivi parashikon gërmim shkëmbi me ekskavator dhe gërmime kanalesh, duke evidentuar ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që lidhen me shembjen e skarpateve, lëvizjen e makinerive dhe punën në gropa/kanale.*

*Në objekt parashikohen gjithashtu instalime elektrike, elektroda tokëzimi, përcjellës dhe sisteme të tjera elektrike. Për depos parashikohen edhe konstruksione metalike, shkallë inoksi, trarë IPE dhe dysHEME metalike, të cilat përfshijnë procese montimi me risk të shtuar.*

*Në këto kushte, kërkesa për ISO 45001 është e nevojshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon një sistem të organizuar për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e riskut, marrjen e masave parandaluese, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, menaxhimin e emergjencave dhe kontrollin e sigurisë së punonjësve gjatë gjithë fazave të realizimit të kontratës.*

*Për rrjedhojë, certifikata është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe riskun e punimeve të preventivit dhe nuk përbën një kërkesë të shkëputur nga objekti.*

*Certifikatë SSH EN ISO 3834-2:2006 / ISO 3834-2:2021 – “Kërkesa të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike”*

*Për këtë certifikatë argumentimi duhet të jetë më specifik, sepse duhet të provohet që në preventiv ekzistojnë realisht punime dhe elemente metalike për të cilat procesi i saldimit ka rëndësi teknike.*

*Preventivi e mbështet këtë kërkesë në disa elemente konkrete.*

*Së pari, objekti përmban një nënobjekt të emërtuar “Ndërtim i linjës së dërgimit nga tubi çelikut 700 mm – Depo 2000 m<sup>3</sup>, Fshati Likmentaj”, çka evidenton praninë e një linje transmetimi me tubacion çeliku me diametër të konsiderueshëm.*

*Gjithashtu, preventivi parashikon në disa nënobjekte furnizim dhe vendosje tubash çeliku. Për shembull, për linjën kryesore Fushë-Kuqe parashikohen 2,380 kg tuba çeliku Ø rreth 200 mm, ndërsa për një nënobjekt tjetër parashikohen 930 kg të tjerë.*

*Së dyti, në ndërtimin e depos së re parashikohen elemente të rëndësishme konstruktive metalike, konkretisht: 14 ml shkallë inoksi me profile metalike; 108 ml trarë metalikë IPE 160 për ndarje kati; 24 ml trarë metalikë IPE 160 për shkallë; 106 m<sup>2</sup> dysHEME metalike me zgarë të zinguar.*

*Po në këtë nënobjekt parashikohet një konstruksion kangjellash me profile hekuri drejtkëndëshe 50×25×2 mm, me gjatësi 145 ml, me vlerë mbi 3 milionë lekë, si dhe dyer dhe elemente të tjera metalike.*

*Këto elemente kërkojnë procese të kontrolluara të fabrikimit dhe bashkimit të strukturave metalike dhe, sipas mënyrës së realizimit të projektit, proceset e saldimit mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në rezistencën mekanike, qëndrueshmërinë, hermeticitetin dhe jetëgjatësinë e elementeve.*

*Për këtë arsye, kërkesa për ISO 3834-2 synon të garantojë që operatori ekonomik që do të realizojë proceset e saldimit disponon një sistem të kontrolluar të cilësisë së saldimit, përfshirë kontrollin e procedurave, personelit, materialeve, pajisjeve dhe inspektimeve të nevojshme.*

**c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:**

- ✓ Tuba Ujësjiellësi PE
- ✓ Tuba Gize
- ✓ Rakorderi
- ✓ Saracineska Gize
- ✓ Matesa uji
- ✓ Pompe Zhytëse
- ✓ Sistem SCADA

#### **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.*

**Shënim:** Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

**d) Për matësat e ujit**

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

**Argumentimi:** Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të paraqesë autorizim të prodhuesit, autorizim nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, si dhe katalogët ose fragmentet e katalogëve të prodhuesit për artikujt tuba ujësjellësi PE, tuba gize, rakorderi, saraçineska gize, matësa uji, pompë zhytëse dhe sistem SCADA, është përcaktuar duke marrë në konsideratë rëndësinë teknike, funksionale dhe ekonomike që këto pajisje e materiale kanë në realizimin e objektit të kontratës.

Objekti konsiston në rikonstruksionin e një rrjeti të gjerë ujësjellësi, ku cilësia dhe përputhshmëria teknike e materialeve dhe pajisjeve të instaluar ndikojnë drejtpërdrejt në jetëgjatësinë e rrjetit, sigurinë e furnizimit me ujë, kontrollin e presioneve, matjen e sasive të ujit dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe komandimit.

Për tubat PE, preventivi parashikon përdorimin e tubacioneve PE100 RC në sasi të konsiderueshme dhe me diametra të ndryshëm. Në linjën e Patokut, për shembull, parashikohen

879 ml DN90, 509 ml DN110, 479 ml DN125 dhe 51 ml DN160. Në Dukagjin të Ri parashikohen ndër të tjera 1,912 ml DN125 dhe 4,320 ml DN200.

Për rrjedhojë, kërkesa për dokumentacion nga prodhuesi dhe katalog teknik është e lidhur me nevojën për të verifikuar që tubat e ofertuar janë pikërisht të tipit, klasës, diametrit dhe presionit të kërkuar dhe se operatori ekonomik ka një burim real dhe të identifikueshëm furnizimi.

Për tubat e gizës dhe rakorderitë, preventivi parashikon tuba gize FFG, fllanxha adaptor, pjesë çmontuese, xhunto, tee, reduksione dhe bërryla me diametra dhe presione të ndryshme. Në linjën e dërgimit evidentohet, ndër të tjera, tub gize FFG DN200 PN16, adaptorë elektrofuzivë, pjesë çmontuese dhe rakorderi të ndryshme.

Këta elementë duhet të jenë të përputhshëm ndërmjet tyre dhe me tubacionet ku do të montohen. Për këtë arsye, katalogu i prodhuesit është i nevojshëm për verifikimin e diametrit nominal, presionit të punës, tipit të lidhjes, materialit dhe karakteristikave të tjera teknike, ndërsa autorizimi siguron lidhjen reale të ofertuesit me zinxhirin e furnizimit.

Për saraçineskat e gizës, preventivi përmban saraçineska me volant dhe saraçineska flutur në DN100, DN150, DN200 dhe DN250, me PN16, si dhe në raste të caktuara PN40. Në një pjesë të preventivit parashikohen, ndër të tjera, 14 copë DN100, 9 copë DN150, 9 copë saraçineska flutur DN200 dhe 4 copë DN250. Në linjën e dërgimit parashikohet edhe saraçineskë gize DN200 PN40.

Duke qenë se këto pajisje realizojnë izolimin, komandimin dhe kontrollin hidraulik të seksioneve të rrjetit, çdo mospërputhje e presionit nominal, dimensioneve, materialit apo mënyrës së lidhjes mund të ndikojë në funksionimin dhe sigurinë e gjithë sistemit. Për këtë arsye, kërkohet identifikimi i prodhuesit dhe verifikimi dokumentar i produktit të ofertuar.

Për matësat e ujit, preventivi përmban matësa induktivë me diametra të ndryshëm. Për linjën kryesore Fushë-Kuqe parashikohen 3 copë DN100, 3 copë DN150, 1 copë DN200 dhe 1 copë DN250, të gjithë PN16. Në Gramëz parashikohen gjithashtu matësa DN100 dhe DN125. Në linjën e dërgimit parashikohet matës uji induktiv DN200 PN16.

Për shkak se matësi është pajisje matëse që duhet të sigurojë saktësi, përsëritshmëri dhe qëndrueshmëri të matjeve gjatë përdorimit, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë mundësi të verifikojë jo vetëm deklarin e ofertuesit, por edhe dokumentacionin teknik të prodhuesit dhe origjinën e pajisjes.

Për sistemin SCADA, kërkesa është veçanërisht e argumentuar, pasi preventivi përmbledhës parashikon një nënobjekt të veçantë “Ndërtimi i sistemit SCADA për pusetat e komandimit. Preventivi përmban pajisje RTU të përshtatshme për komunikim me programin SCADA ekzistues, si dhe pajisje elektronike për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave. Në preventiv evidentohen gjithashtu program SCADA, modem komunikimi dhe elemente të tjera të sistemit.

*Në këtë rast autorizimi i prodhuesit/distributorit dhe katalogu teknik janë të nevojshëm jo vetëm për origjinën e pajisjeve, por edhe për të verifikuar kompatibilitetin, ndërveprueshmërinë dhe integrimin e pajisjeve të reja me sistemin SCADA ekzistues.*

*Kërkesa që autorizimi të jetë i vlefshëm deri në realizimin e plotë të punimeve argumentohet gjithashtu nga nevoja që marrëdhënia me prodhuesin/distributorin të ekzistojë gjatë gjithë periudhës së furnizimit, montimit, testimit dhe vënies në punë dhe jo vetëm në momentin e ofertimit.*

*Katalogët ose fragmentet e katalogëve të prodhuesit kërkohen për të mundësuar krahasimin objektiv ndërmjet karakteristikave të produktit të ofertuar dhe specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor. Kërkesa që fragmenti të identifikojë qartë prodhuesin dhe katalogun nga i cili është marrë shërben për të shmangur paraqitjen e materialeve teknike të paidentifikueshme ose të hartuara vetëm për procedurën e prokurimit.*

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë dokumentacionin për artikujt që ka marrë përsipër të furnizojë është e lidhur me ndarjen reale të detyrimeve të përcaktuara në kontratën e bashkëpunimit dhe siguron që dokumentacioni teknik dhe autorizimet të lidhen me subjektin që do të realizojë konkretisht furnizimin përkatës.*

*Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi/distributori i autorizuar që vërteton se standardi i prodhimit të matësve të ujit është sipas OIML R49 ose ekuivalent, lidhet drejtpërdrejt me funksionin e këtyre pajisjeve.*

*Preventivi tregon se në rrjet do të instalohen matësja uji induktivë me diametra të ndryshëm, përfshirë DN100, DN125, DN150, DN200 dhe DN250. Kjo tregon se matja e prurjeve është pjesë funksionale e sistemit dhe jo një element dytësor.*

*Në këtë kontekst, kërkesa për një standard metrologjik të njohur ose ekuivalent synon të garantojë që pajisjet matëse të ofruara të kenë karakteristika të verifikueshme sa i përket saktësisë së matjes, performancës dhe qëndrueshmërisë metrologjike.*

*Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një sistem ujësjellësi, pasi të dhënat e gjeneruara nga matësat përdoren për kontrollin e prurjeve, evidentimin e konsumit dhe humbjeve, balancimin hidraulik dhe administrimin e rrjetit.*

*Pra, kërkesa nuk vendoset për të përcaktuar një markë apo prodhues të caktuar, por për të siguruar një nivel të matshëm dhe të verifikueshëm të performancës së produktit, duke pranuar edhe standarde ekuivalente.*

*Edhe kërkesa për certifikatën e aprovimit MID ose ekuivalente lidhet me faktin se matësat e ujit janë instrumente matëse dhe saktësia e tyre ka rëndësi të drejtpërdrejtë në funksionimin dhe administrimin e rrjetit.*

*Preventivi nuk parashikon një tip të vetëm matësi, por disa diametra dhe pozicione instalimi. Vetëm në Fushë-Kuqe vlera e matësve DN100, DN150, DN200 dhe DN250 është respektivisht rreth 650 mijë, 1.086 milionë, 416 mijë dhe 531 mijë lekë.*

*Kërkesa për aprovimin MID/ekuivalent synon që Autoriteti Kontraktor të ketë siguri se instrumenti matës është projektuar, prodhuar dhe vlerësuar për përputhshmëri sipas kërkesave të zbatueshme për pajisjet matëse dhe se rezultatet e matjes janë të besueshme gjatë përdorimit.*

*Në këtë mënyrë, kombinimi i kërkesave për katalog teknik + dokument të prodhuesit + OIML R49/ekuivalent + MID/ekuivalent krijon një mekanizëm të plotë verifikimi: katalogu identifikon produktin dhe parametrat teknikë; autorizimi provon lidhjen reale të ofertuesit me prodhuesin/distributorin; OIML R49/ekuivalent provon parametrat dhe performancën metrologjike; MID/ekuivalent provon konformitetin e instrumentit matës sipas kërkesave përkatëse.*

**2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- a)** Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën **120 (njqind e njezet)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se 120 (njqind e njezet) punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

*Kërkesa që Operatori Ekonomik pjesëmarrës të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 120 (njqind e njezet) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, vlerën, volumin, kompleksitetin teknik, shtrirjen territoriale dhe shumëllojshmërinë e proceseve të punës të parashikuara për realizimin e objektit të kontratës.*

*Objekti “Rikonstruktion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njesisë Administrative Fushë-Kuqe dhe Thumanë, Bashkitë Kurbin dhe Krujë” nuk përbëhet nga një kantier apo proces i vetëm pune. Sipas preventivit përmbledhës, kontrata përfshin: ndërtimin e linjës së dërgimit me tub çeliku 700 mm drejt depos 2,000 m<sup>3</sup>; ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>; ndërtimin e linjave kryesore të rrjetit shpërndarës në Fushë-Kuqe, Thumanë dhe Gramëz; ndërtimin e rrjeteve shpërndarëse në Patok, Gorre, Adriatik, Dukagjin i Ri, Bushnesh, Sukth Vendas dhe në disa zona të Gramëzit; ndërtimin dhe integrimin e sistemit SCADA për pusetat e komandimit.*

*Kjo strukturë e objektit evidenton nevojën për organizimin e disa fronteve të punës, me grupe pune të dedikuara për procese të ndryshme, në mënyrë që punimet të realizohen brenda afatit kontraktual dhe pa krijuar ndërprerje ndërmjet proceseve të njëpasnjëshme.*

*Nga analiza e preventivit rezulton se punimet përfshijnë një numër të madh procesesh që kërkojnë kategori të ndryshme punonjësish, si: gjurmime manuale dhe të mekanizuara, transport të dherave, mbushje dhe ngjeshje, vendosje tubacionesh, montim rakorderish, saraçineskash dhe pajisjesh hidraulike, punime betoni e betonarmeje, armim, kallëp, punime rrugore dhe asfaltim, punime elektrike dhe tokëzimi, punime metalike, hidroizolim, instalim pajisjesh teknologjike, si dhe punime elektronike dhe automatizimi të lidhura me SCADA-n.*

*Volumet konkrete të preventivit konfirmojnë intensitetin e lartë të punimeve. Për shembull, vetëm për depon e re parashikohen 13,710 m<sup>3</sup> gjurmim mekanik në kanale, 230 m<sup>3</sup> gjurmim manual në tokë të fortë, si dhe punime mbushjeje dhe veprash arti. Në të njëjtin nënobjekt parashikohen 39 ton hekur Ø6–10 mm dhe 109 ton hekur Ø>12 mm, si dhe 590 m<sup>2</sup> skelë metalike.*

*Ndërtimi i depos kërkon gjithashtu volume të larta betonarmeje, konkretisht 371 m<sup>3</sup> beton C30/37 për pllakën e rezervuarit, 358 m<sup>3</sup> për muret, 181 m<sup>3</sup> për soletën, 19 m<sup>3</sup> për trarët dhe 21.5 m<sup>3</sup> për kolonat, duke kërkuar angazhim të koordinuar të betonuesve, hekurkthyesve, karpentierëve, manovratorëve dhe stafit teknik.*

*Edhe nënobjektet e rrjeteve shpërndarëse kanë volume të konsiderueshme. Vetëm në Gramëz, Zona nr. 4, parashikohen 694.40 m<sup>3</sup> gjurmime manuale në tokë të butë, 510.80 m<sup>3</sup> në tokë të zakonshme dhe 5,365.70 m<sup>3</sup> gjurmime mekanike, krahas punimeve të mbushjes dhe ngjeshjes.*

*Punimet rrugore që shoqërojnë shtrimin e tubacioneve kërkojnë po ashtu grupe të specializuara. Në Adriatik parashikohen 1,912 m<sup>2</sup> shtresë binder dhe 1,912 m<sup>2</sup> asfaltobeton, së bashku me punime betoni dhe betonarmeje. Në Bushnesh parashikohen 1,562 m<sup>2</sup> binder dhe 1,562 m<sup>2</sup> asfaltobeton, ndërsa në Dukagjin të Ri 1,649 m<sup>2</sup> për secilën prej këtyre shtresave.*

*Përveç punimeve civile dhe hidroteknike, objekti përmban edhe instalime elektrike dhe elektronike. Në depon e re parashikohen instalime ndriçimi, përcjellës, elektroda dhe sistem tokëzimi, ndërsa objekti përfshin gjithashtu sistemin SCADA dhe pajisjet e komandimit.*

*Këto volume dhe procese nuk mund të realizohen nga një grup i vetëm punonjësish në mënyrë lineare. Për realizimin efektiv të kontratës kërkohet organizimi paralel i:*

grupeve të gjurmimit dhe transportit, grupeve për shtrimin dhe montimin e tubacioneve, grupeve të punimeve hidraulike, grupeve të betonit dhe betonarmesë, grupeve të armimit dhe kallëpit, grupeve të rikthimit të shtresave rrugore dhe asfaltimit, personelit elektrik/elektronik dhe SCADA, si dhe stafit drejtues, teknik dhe mbështetës.

Në këto kushte, kërkesa për disponimin mesatar të të paktën 120 punonjësve synon të vërtetojë se operatori ekonomik zotëron një strukturë organizative dhe kapacitet njerëzor të konsoliduar, të aftë për të përballuar një kontratë me vlerë mbi 1.238 miliardë lekë pa TVSH, me një numër të madh nënobjektesh dhe fronte pune të shpërndara në territor.

Kërkesa nuk synon vetëm evidentimin formal të numrit të punonjësve, por krijimin e një sigurie të arsyeshme për Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik disponon kapacitetin njerëzor të nevojshëm për të garantuar:

realizimin e njëkohshëm të disa proceseve dhe fronteve të punës; vazhdimësinë e punimeve; respektimin e grafikut të zbatimit; përdorimin efektiv të makinerive dhe pajisjeve; realizimin e proceseve të specializuara; si dhe përfundimin e kontratës brenda afatit dhe me cilësinë e kërkuar.

Për këtë arsye, kërkesa për një mesatare minimale prej 120 punonjësish është vendosur në funksion të kapacitetit teknik dhe organizativ të nevojshëm për realizimin e objektit dhe lidhet me volumin e konsiderueshëm të punimeve, numrin e nënobjekteve, shtrirjen e gjerë territoriale dhe domosdoshmërinë e zhvillimit paralel të disa proceseve ndërtimore dhe teknologjike.

Numri minimal prej 120 punonjësish është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumin e përgjithshëm të punimeve, vlerën e kontratës prej 1,238,587,632.81 lekë pa TVSH, numrin e konsiderueshëm të nënobjekteve dhe shpërndarjen e tyre në disa zona gjeografike, si dhe nevojën për organizimin e njëkohshëm të disa fronteve të punës. Preventivi përmban punime masive gjurmimi e transporti, shtrim tubacionesh, montime hidraulike, betonarme, armim, kallëp, rikonstrukcion të shtresave rrugore, asfaltim, instalime elektrike dhe sisteme automatizimi/SCADA. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet angazhimi i njëkohshëm i stafit teknik, punonjësve të kualifikuar dhe fuqisë punëtore mbështetëse. Për rrjedhojë, disponimi i një numri të mjaftueshëm punonjësish përbën tregues të kapacitetit organizativ të operatorit ekonomik për përballimin e kontratës dhe për realizimin e saj brenda afateve të përcaktuara.”

**b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:**

|                                          |         |
|------------------------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi                     | 2 (dy)  |
| - Inxhinier Ndërtimi, Profili Gjeoteknik | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektroteknik                | 1 (një) |
| - Inxhinier Mekanik                      | 2 (dy)  |

- Inxhinier Hidroteknik 2 (dy)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik 2 (dy)
- Inxhinier Hidrogeolog 1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe te figuroje ne Listepagesa per te pakten 3 muajt e Fundit.

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

- ❖ *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Teknik Topograf 2 (dy)
- Teknik Hidroteknik 1 (një)
- Hidraulik 8 (tete)
- Karpentierë 7 (shtate)
- Hekurkthyes 7 (shtate)
- Betonues 5 (pese)
- Saldator 4 (kater)
- Konstruksione metalike 2 (dy)
- Elektromekanike 1 (nje)
- Hidroizolues 4 (kater)
- Elektricitist 4 (kater)
- Specialiste IT 2 (dy)
- Mekanike 3 (tre)
- Punëtorë asfalti 4 (kater)
- Punëtorë te thjeshte 5 (pesë)
- 4 (kater) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe certificate aftesimit profesional (CAP), leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (*me përjashtim të punonjësve shoferë*) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

**Shënim:** Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- 3 (tre) Eskavatoristë
- 3 (tre) Automakinist
- 2 (dy) Buldozerist

të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas

legjislacionit përkatës; dhe /ose c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërkohë, me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 80 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në këtë përlllogaritje njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, periudhën 24 muaj, dhe në përfundim në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

Në staf përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtues të mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve, grafikun, llojin dhe natyrën e punimeve që do të kryhen si: gërmime, ngjeshje, sisteme, shtrim tubacione, punimet për rrjetin, pusetat, depot, pusin, stacion pompimi, rehabilitim i segmenteve rrugore etj, të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit, 24 muaj. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllim për të patur rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoroz të punimeve. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës, me qëllim ndërtimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, referuar zërave (natyrës) të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerësojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.

Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku citojmë: Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrëkt të projektit dhe cilësinë e punimeve. Kërkohet për shkak të punimeve civile të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë: gërmime; themele; beton dhe betonarme; mure dhe struktura mbajtëse; godina teknologjike; puseta; rikonstruksione dhe sistemime sipërfaqesh.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë personelin kryesor dhe drejtuesit teknikë të përcaktuar në licencën e shoqërisë është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën shumëdisiplinore të objektit, volumin dhe kompleksitetin e punimeve, numrin e nënobjekteve, si dhe nevojën për drejtimin dhe kontrollin profesional të proceseve të ndryshme që do të zhvillohen gjatë zbatimit të kontratës.

Preventivi përmbledhës përfshin ndërtimin e linjës së dërgimit me tub çeliku Ø700 mm, ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>, linjat kryesore të shpërndarjes në Fushë-Kuqe, Thumanë dhe Gramëz, disa rrjete shpërndarëse në zona të ndryshme dhe sistemin SCADA, me një vlerë totale të punimeve prej rreth 1.238 miliardë lekësh pa TVSH.

## 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi

Kërkesa për 2 inxhinierë ndërtimi argumentohet nga volumi i konsiderueshëm i punimeve civile dhe strukturore dhe nga fakti se objekti zhvillohet në disa nënobjekte dhe fronte pune.

Preventivi përmban në mënyrë të përsëritur punime betoni e betonarmeje, hekur betoni, struktura monolite, themele, puseta, shtresa rrugore, asfaltim, kallëpe, skela dhe struktura të tjera ndërtimore. Për shembull, vetëm në depon e re parashikohen 39 ton hekur Ø6–10 mm, 109 ton hekur Ø>12 mm dhe 590 m<sup>2</sup> skelë metalike.

Për rezervuarin parashikohen gjithashtu volume të konsiderueshme betoni C30/37 për pllakën, muret, soletën, trarët dhe kolonat. Ndërkohë, punime betoni e betonarmeje gjenden edhe në rrjetet shpërndarëse; në Gramëz Zona 4, për shembull, parashikohen struktura C16/20 dhe C20/25 dhe 5.25 ton hekur betoni.

Për këtë arsye, 2 inxhinierë ndërtimi justifikohen nga nevoja për mbikëqyrjen e njëkohshme të punimeve të depos dhe strukturave civile nga njëra anë dhe punimeve civile të rrjeteve, pusetave dhe rikthimit të infrastrukturës rrugore nga ana tjetër.

## 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, Profili Gjeoteknik

*Kërkesa për inxhinierin gjeoteknik lidhet drejtpërdrejt me volumin dhe llojin e punimeve të gërmimit dhe me ndryshueshmërinë e terrenit ku realizohen linjat.*

*Preventivi përmban gërmime në tokë të butë, tokë të zakonshme, tokë të fortë, gërmime mekanike në kanale dhe gërmime në shkëmb. Në linjën e dërgimit parashikohen, ndër të tjera, 249 m<sup>3</sup> gërmim shkëmbi, 125 m<sup>3</sup> gërmim në tokë të zakonshme, 170 m<sup>3</sup> në tokë të fortë dhe 931.60 m<sup>3</sup> gërmim mekanik.*

*Në nënobjekte të tjera volumet janë shumë më të mëdha; në Gramëz Zona 4 parashikohen mbi 5,365 m<sup>3</sup> gërmime mekanike, krahas gërmimeve manuale në kategori të ndryshme toke. Ndërsa në Gorre parashikohen 2,651 m<sup>3</sup> gërmime në tokë të fortë dhe 9,935.50 m<sup>3</sup> gërmime mekanike.*

*Për rrjedhojë, profili gjeoteknik është i nevojshëm për vlerësimin e sjelljes së terrenit gjatë gërmimit, kontrollin e skarpateve dhe kanaleve, stabilitetin e bazamentit, kushtet e mbushjes dhe ngjeshjes dhe përshtatjen e zgjidhjeve të zbatimit me kushtet reale të tokës.*

#### **1 (një) Inxhinier Elektroteknik**

*Kërkesa për inxhinierin elektroteknik argumentohet nga ekzistenca e një komponenti të qartë elektrik dhe automatizimi në objekt.*

*Preventivi për depon përmban kablllo elektrike, tubacione mbrojtëse, kuadër komandimi, sistem tokëzimi, përcjellës bakri, rrufepritës, linjë kablllore 5×6 mm<sup>2</sup> dhe kuadër elektrik të depos.*

*Gjithashtu, objekti përmban pajisje RTU për komunikim në distancë me sistemin SCADA ekzistues. Vetë preventivi përmbledhës parashikon një nënobjekt të veçantë për ndërtimin e sistemit SCADA, me vlerë rreth 16.55 milionë lekë.*

*Për rrjedhojë, inxhinieri elektroteknik është i domosdoshëm për drejtimin, kontrollin dhe koordinimin e instalimeve elektrike, sistemeve të tokëzimit, furnizimit me energji dhe ndërfaqeve elektrike të pajisjeve të automatizimit.*

#### **2 (dy) Inxhinierë Mekanikë**

*Kërkesa për 2 inxhinierë mekanikë argumentohet nga volumi dhe kompleksiteti i pajisjeve mekanike dhe hidromekanike të rrjetit.*

*Preventivi parashikon tubacione çeliku, tuba gize, flanaxha, pjesë çmontuese, saraçineska, valvula reduktimi presioni, valvula shkarkimi presioni, filtra, matësa, rakorderi dhe pajisje të tjera mekanike.*

*Në linjën e dërgimit përfshihen, ndër të tjera, saraçineskë gize DN200 PN40, Tee gize, flanaxha çeliku, valvul shkarkimi presioni dhe valvul reduktuese presioni me parametra deri në 40 bar.*

*Po kështu, depoja përmban konstruksione dhe pajisje mekanike të ndryshme, ndërsa linjat e rrjetit kanë një numër shumë të madh valvulash dhe rakorderish.*

*Dy inxhinierë mekanikë justifikohen nga nevoja që një pjesë e stafit të mbulojë montimin dhe kontrollin e linjave dhe pajisjeve mekanike/hidromekanike të rrjetit, ndërsa tjetri të fokusohet në*

*pajisjet, konstruksionet dhe sistemet mekanike të depos dhe nyjeve teknologjike, duke qenë se këto procese mund të zhvillohen paralelisht.*

## *2 (dy) Inxhinierë Hidroteknikë*

*Kjo është një nga kërkesat më të lidhura drejtpërdrejt me objektin.*

*Objekti në thelb është një sistem ujësjellësi, që përfshin linjë dërgimi, depo 2,000 m<sup>3</sup>, linja kryesore dhe një numër të madh linjash shpërndarëse.*

*Vetëm në linjën kryesore Thumanë, preventivi parashikon tuba PE100 RC në shumë diametra, përfshirë 602 ml DN25, 536 ml DN32, 1,984 ml DN50, 2,331 ml DN160 dhe 3,177 ml DN250, krahas tubave të gizës dhe rakorderive. Në Gramëz parashikohen gjithashtu volume të konsiderueshme të tubave PE100 RC deri në DN250.*

*Për këtë arsye, inxhinierët hidroteknikë janë të domosdoshëm për kontrollin e shtrimit të linjave, kuotave hidraulike, rakorderive, valvulave, pusetave, lidhjeve, presioneve, testimeve dhe funksionimit të sistemit.*

*Numri 2 (dy) argumentohet edhe nga shtrirja e objektit: njëri mund të mbulojë linjën e dërgimit, depon dhe linjat kryesore, ndërsa tjetri rrjetet e shumta shpërndarëse dhe pusetat/nyjet e komandimit, procese që për shkak të shtrirjes së punimeve pritet të zhvillohen në disa fronte.*

## *2 (dy) Inxhinierë Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik*

*Kërkesa për 2 specialistë të profilit topogjeodezik argumentohet kryesisht nga karakteri linear dhe shtrirja territoriale e objektit.*

*Preventivi përmbledhës tregon se punimet nuk zhvillohen në një pikë të vetme, por në një numër të madh zonash: Fushë-Kuqe, Thumanë, Gramëz, Patok, Gorre, Adriatik, Dukagjin i Ri, Bushnesh, Sukth Vendas dhe zona të tjera të Gramëzit.*

*Shtrimi i kilometrave të tubacioneve me diametra të ndryshëm kërkon përcaktimin e akseve, kuotave, niveleve, pozicionimit të pusetave dhe kontrollin e zbatimit të traseve. Për shembull, vetëm në Dukagjin të Ri parashikohen 4,320 ml tub PE100 RC DN200, krahas linjave të tjera me diametra të ndryshëm.*

*Për këtë arsye, dy inxhinierë topografë/gjeodetë janë të justifikueshëm për mbulimin e njëkohshëm të disa fronteve, për piketimin, kontrollin e kuotave dhe përgatitjen e rlevimeve të zbatimit.*

*Kujdes: preventivi nuk ka një zë të veçantë të emërtuar “punime topografike”. Argumentimi këtu rrjedh nga natyra lineare dhe shtrirja e rrjetit, jo nga një zë specifik i preventivit.*

## *1 (një) Inxhinier Hidrogeolog*

*Kërkesa për disponimin e 1 (një) Inxhinieri Hidrogeolog është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në rikonstruksionin dhe ndërtimin e një sistemi të gjerë ujësjellësi, ndërtimin e linjave kryesore dhe shpërndarëse, si dhe ndërtimin e depos së re me kapacitet 2,000 m<sup>3</sup>.*

Natyra e punimeve të parashikuara në preventiv përfshin volume të konsiderueshme gërmimesh në kategori të ndryshme terreni, hapje kanalesh për vendosjen e tubacioneve, gërmime mekanike në thellësi, ndërtim strukturash nëntokësore, pusetash dhe veprash kullimi. Për ndërtimin e depos së re, preventivi parashikon 13,710 m<sup>3</sup> gërmim mekanik në kanale, krahas 230 m<sup>3</sup> gërmime në tokë të fortë, si dhe punime për puseta kontrolli dhe kullim.

Gjithashtu, në linjën kryesore të Fushë-Kuqes parashikohen 11,378.80 m<sup>3</sup> gërmime mekanike në kanale, krahas gërmimeve në tokë të butë, të zakonshme, të fortë dhe në shkëmb. Në Thumanë parashikohen 6,940.20 m<sup>3</sup> gërmime mekanike, ndërsa në Gorre rreth 9,935.50 m<sup>3</sup>, përveç volumeve të konsiderueshme të gërmimeve manuale në kategori të ndryshme terreni.

Këto punime, për shkak të shtrirjes së tyre dhe realizimit në nivele të ndryshme të terrenit, mund të ndërveprojnë me kushtet hidro-gjeologjike lokale dhe me prania eventuale të ujërave nëntokësore gjatë hapjes së kanaleve dhe themeleve. Për këtë arsye, prania e një specialisti hidrogeolog është e nevojshme për të vlerësuar dhe ndjekur kushtet e ujërave nëntokësore që mund të shfaqen gjatë zbatimit, ndikimin e tyre në stabilitetin dhe sigurinë e gërmimeve, si dhe nevojën për masa të përkohshme kullimi ose largimi të ujit nga frontet e punës.

Kjo nevojë mbështetet edhe nga fakti se preventivi për ndërtimin e depos përmban një kapitull të posaçëm “Punime të ndryshme për kullim ujitje”, ku parashikohet vendosja e tombinos rrethore Ø1000 mm. Po kështu, në zonën e depos parashikohen puseta shkarkimi dhe puseta shiu, të cilat evidentojnë nevojën për menaxhimin dhe largimin e ujërave në zonën e veprës.

Në këtë kuadër, Inxhinieri Hidrogeolog do të ketë rol në vlerësimin e kushteve hidro-gjeologjike gjatë punimeve të gërmimit, evidentimin e shfaqjeve të ujërave nëntokësore, vlerësimin e ndikimit të tyre në kanalet, themelet dhe strukturat e objektit, si dhe rekomandimin e masave teknike për drenazhimin, uljen ose kontrollin e nivelit të ujit kur kjo rezulton e nevojshme gjatë zbatimit.

Për më tepër, ndërtimi i një depoje të re 2,000 m<sup>3</sup>, së bashku me linjën e dërgimit dhe rrjetet e gjera të ujësjellësit, kërkon koordinim ndërmjet kushteve të terrenit, veprave nëntokësore dhe sistemit hidraulik. Vetë preventivi parashikon në depon e re edhe matës niveli ultrasonik, krahas tubacioneve dhe pajisjeve hidraulike të saj.

Për rrjedhojë, kërkesa për 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog konsiderohet e lidhur me natyrën e punimeve të objektit dhe me nevojën për kontroll profesional të problematikave që mund të krijohen nga ndërveprimi i gërmimeve, themeleve dhe veprave nëntokësore me regjimin e ujërave nëntokësore, duke synuar realizimin e sigurt dhe teknikisht korrekt të punimeve.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë 1 (një) Inxhinier Elektrik dhe 1 (një) Inxhinier Elektronik, si staf tjetër inxhinierik, është përcaktuar në përputhje me natyrën e punimeve dhe pajisjeve të parashikuara në preventivin e objektit, të cilat përfshijnë instalime elektrike, sisteme tokëzimi, kuadro komandimi, pajisje elektronike, sisteme komunikimi në distancë dhe sistem SCADA.

Inxhinieri Elektrik, nevoja lidhet me zërat konkretë të preventivit që lidhen me realizimin dhe kontrollin e instalimeve elektrike. Në ndërtimin e depos së re parashikohen, ndër të tjera, kablo

elektrike 3x2.5 mm<sup>2</sup>, tubacione mbrojtëse për instalimet, kuadër komandimi, kabllo TU me izolim PVC/XLPE, përcjellës mbrojtës bakri, zbarra tokëzimi, elemente të sistemit rrufepritës, linjë kabllorë bakri 5x6 mm<sup>2</sup> 3x380V+N dhe kuadër elektrik i depos.

Preventivi parashikon gjithashtu instalime të posaçme ndriçimi dhe tokëzimi, përfshirë ndriçues, përcjellës PV-500, priza, elektroda tokëzimi, përcjellës Zn dhe përcjellës tokëzimi Cu.

Për rrjedhojë, angazhimi i një Inxhinieri Elektrik është i nevojshëm për drejtimin teknik, kontrollin dhe koordinimin e punimeve elektrike, verifikimin e instalimeve të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë, kuadrove elektrike, tokëzimit, mbrojtjes nga rrufeja, kabllorë dhe pajisjeve elektrike, si dhe për kontrollin e përputhshmërisë së tyre me projektin dhe specifikimet teknike.

Për Inxhinierin Elektronik, është i nevojshëm nga komponenti i veçantë i automatizimit, monitorimit dhe komunikimit në distancë që përmban objekti. Preventivi parashikon pajisje elektronike memorizuese dhe kontrolluese me modul komunikimi në distancë RTU, të përshtatshme për të komunikuar me programin SCADA ekzistues.

Gjithashtu, në preventivin e sistemit SCADA parashikohen kompjuter desktop, ruter për lidhje interneti, modem komunikimi të postit qendror me pajisjet në objekte, program SCADA dhe dhënës niveli piezometrik 4–20 mA me kabllo.

Këto pajisje kërkojnë njohuri të posaçme në elektronikë, instrumentacion, transmetim dhe përpunim sinjalesh, komunikim ndërmjet pajisjeve, programim/konfigurim të moduleve RTU dhe integrim me sistemin SCADA.

Për rrjedhojë, Inxhinieri Elektronik është i nevojshëm për konfigurimin, kontrollin dhe integrimin e pajisjeve elektronike dhe të komunikimit, verifikimin e sinjaleve dhe parametrave të transmetimit, koordinimin e pajisjeve RTU me programin SCADA, si dhe kontrollin e funksionimit të sistemit të monitorimit dhe automatizimit.

Kërkesa për disponimin e stafit teknik të specializuar është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, volumin, kompleksitetin dhe shtrirjen territoriale të punimeve të parashikuara në preventiv, si dhe nevojën për organizimin e njëkohshëm të disa fronteve të punës.

Objekti nuk konsiston në realizimin e një nënobjekti të vetëm, por në ndërtimin/rikonstruksionin e një sistemi të gjerë ujësjellësi, me linja kryesore dhe shpërndarëse, depo të re 2,000 m<sup>3</sup>, struktura betonarme, punime të konsiderueshme gërmimi, vendosje tubacionesh dhe rakorderish, si dhe rikthimin e sipërfaqeve të prekura nga punimet.

#### 1. Teknik Ndërtimi – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Teknikë Ndërtimi është e lidhur me volumin dhe shumëllojshmërinë e punimeve civile dhe strukturore që shoqërojnë realizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe, në mënyrë të veçantë, me ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>.

Preventivi për ndërtimin e depos përmban punime të konsiderueshme të gërmimit, shtresave, betonit, betonarmesë, armaturës dhe elementeve konstruktive. Vetëm për këtë nënobjekt

parashikohen 39 ton hekur betoni Ø6–10 mm dhe 109 ton hekur Ø>12 mm, pra rreth 148 ton armaturë, si dhe 590 m<sup>2</sup> skelë metalike.

Përveç depos, punimet e betonit dhe betonarmesë përsëriten në nënobjektet e rrjeteve shpërndarëse. Për shembull, në rrjetin e fshatit Gorre preventivi parashikon: 12.00 m<sup>3</sup> struktura monolite betoni C16/20; 1.50 m<sup>3</sup> struktura monolite betoni C20/25; 38.16 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite C20/25; 7.95 ton hekur betoni Ø6–10 mm.

E njëjta natyrë punimesh konstatohet edhe në Gramëz, Zona nr. 3, ku parashikohen struktura betoni C16/20 dhe C20/25, struktura të holla monolite dhe 5.40 ton hekur betoni.

Në Gramëz, Zona nr. 2, parashikohen gjithashtu struktura monolite C16/20 dhe C20/25, 26.64 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite dhe 5.55 ton hekur betoni.

Pra, tekniku i ndërtimit nuk nevojitet vetëm për një strukturë të vetme, por për një seri procesesh të shpërndara në nënobjekte të ndryshme: kontrollin e gjurmëve dhe bazamenteve, punimeve të betonit dhe betonarmesë, armaturës, kallëpeve, pusetave, shtresave dhe rikthimit të elementeve të infrastrukturës.

Numri prej 2 (dy) teknikësh argumentohet edhe nga nevoja për ndarjen e mbulimit teknik të fronteve të punës. Njëri teknik mund të angazhohet kryesisht në punimet strukturore të depos 2,000 m<sup>3</sup> dhe strukturave të lidhura me të, ndërsa tekniku tjetër në punimet civile të linjave kryesore dhe rrjeteve shpërndarëse, pusetave dhe rikthimit të infrastrukturës së prekur.

Në kushtet kur këto procese duhet të zhvillohen paralelisht, disponimi i vetëm një tekniku do të kufizonte mundësinë e kontrollit të vazhdueshëm në fronte të ndryshme.

Për rrjedhojë, kërkesa për 2 Teknikë Ndërtimi është e lidhur drejtpërdrejt me volumin e punimeve civile dhe strukturore, numrin e nënobjekteve dhe nevojën për kontroll teknik të njëkohshëm të proceseve të zbatimit.

## 2. Teknik Topograf – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Teknikë Topografë argumentohet kryesisht nga karakteri linear, gjatësia dhe shtrirja territoriale e rrjetit që do të ndërtohet.

Punimet e ujësjellësit kërkojnë kontroll të vazhdueshëm topografik që nga faza e piktimit të aksit të tubacionit deri në përfundimin e tij. Në praktikën e zbatimit, ky profil është i lidhur me përcaktimin dhe materializimin e aksit, kontrollin e kuotave, niveleve dhe pozicionimit të pusetave dhe elementeve të rrjetit.

Nevoja bëhet veçanërisht e dukshme nga gjatësitë e konsiderueshme të tubacioneve të parashikuara në preventiv.

Në linjën kryesore të Thumanës, për shembull, parashikohen ndër të tjera: 602 ml tub PE100 RC DN25; 536 ml DN32; 1,984 ml DN50; 2,331 ml DN160; 3,177 ml DN250, përveç diametrave dhe elementeve të tjera të rrjetit.

*Në Dukagjin të Ri, vetëm tubacioni PE100 RC DN200 arrin në 4,320 ml, krahas linjave të tjera me diametra të ndryshëm.*

*Këto janë linja që kërkojnë piketim dhe kontroll gjatë hapjes së kanalit dhe vendosjes së tubacionit. Gabimet në pozicionimin horizontal apo vertikal të rrjetit mund të krijojnë probleme në lidhjen e segmenteve, pozicionimin e pusetave dhe rakorderive dhe përputhjen e punimeve faktike me projektin.*

*Kërkesa për topografë lidhet gjithashtu me volumin e gërmimeve lineare. Në Gorre, për shembull, parashikohen: 1,117.20 m<sup>3</sup> gërmime kanalesh në tokë të butë; 1,253.00 m<sup>3</sup> në tokë të zakonshme; 2,651.00 m<sup>3</sup> në tokë të fortë; 9,935.50 m<sup>3</sup> gërmime mekanike në kanale.*

*Në Gramëz, Zona nr. 2, parashikohen 5,993.90 m<sup>3</sup> gërmime mekanike, krahas gërmimeve manuale në kategori të ndryshme terreni.*

*Këto volume dëshmojnë gjatësinë dhe shtrirjen e kanaleve ku do të vendosen tubacionet dhe, rrjedhimisht, nevojën për kontroll topografik gjatë realizimit.*

*Numri prej 2 (dy) Teknikësh Topografë argumentohet nga fakti se objekti zhvillohet në shumë zona dhe nënobjekte dhe jo në një front të vetëm. Punimet në linjat kryesore, në depon 2,000 m<sup>3</sup> dhe në rrjetet shpërndarëse mund të zhvillohen paralelisht.*

*Për rrjedhojë, dy teknikë mundësojnë mbulimin e njëkohshëm të fronteve të ndryshme, pa kushtëzuar vijimësinë e punimeve të një grupi nga përfundimi i matjeve në një zonë tjetër.*

*Kërkesa për 2 Teknikë Topografë është, për rrjedhojë, e lidhur me gjatësinë e tubacioneve, volumin e kanaleve, numrin e nënobjekteve dhe domosdoshmërinë e zhvillimit paralel të punimeve në disa zona.*

### *3. Teknik Hidroteknik – 1 (një)*

*Kërkesa për 1 (një) Teknik Hidroteknik lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vetë objektin e kontratës, pasi komponenti kryesor i punimeve është ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit.*

*Preventivi përmban një sistem të gjerë tubacionesh PE100 RC, tuba çeliku dhe gize, rakorderi, saraçineska, valvula, matësa, puseta dhe pajisje të tjera hidraulike.*

*Në linjën e dërgimit, për shembull, parashikohen: saraçineskë gize DN200 PN40; Tee gize DN200×100×200 PN16; Tee gize DN200×200×200 PN16; Tee gize DN250×100×250 PN16; fllanxhë çeliku DN200 PN40; valvul lëshimi presioni DN200; valvul reduktuese presioni DN200.*

*Këto pajisje nuk përfaqësojnë thjesht materiale ndërtimi, por elemente funksionale të sistemit hidraulik që duhet të instalohen në pozicionet dhe sipas parametrave të projektit.*

*Tekniku hidroteknik është i nevojshëm për ndjekjen e përditshme të proceseve të shtrimit dhe montimit të tubacioneve, kontrollin e elementeve të rrjetit, lidhjeve, rakorderive, saraçineskave dhe pusetave, si dhe për asistencën teknike gjatë kontrollit dhe provave të rrjetit.*

*Roli i tij plotëson drejtimin inxhinierik: ndërsa inxhinieri hidroteknik kryen drejtimin dhe kontrollin profesional të nivelit inxhinierik, tekniku hidroteknik siguron ndjekjen operative të vazhdueshme të proceseve të montimit në kantier.*

*Numri 1 (një) është proporcional me këtë rol mbështetës dhe me faktin që në strukturën e kërkuar janë parashikuar veçmas edhe inxhinierë hidroteknikë dhe një numër i konsiderueshëm hidraulikësh.*

#### *4. Hidraulik – 8 (tetë)*

*Kërkesa për 8 (tetë) Hidraulikë është ndër kërkesat që lidhet më drejtpërdrejt me volumin e objektit.*

*Pjesa kryesore e kontratës konsiston në shtrimin dhe montimin e tubacioneve të ujësjellësit, rakorderive, valvulave, saraçineskave, pjesëve speciale dhe pajisjeve të tjera të rrjetit.*

*Vetëm në linjën kryesore të Thumanës parashikohen mijëra metra tubacione PE100 RC me diametra të ndryshëm, përfshirë 2,331 ml DN160 dhe 3,177 ml DN250, përveç DN25, DN32, DN50 dhe diametrave të tjerë.*

*Në Dukagjin të Ri parashikohen 4,320 ml tub PE100 RC DN200, krahas tubacioneve të tjera.*

*Pra, kemi të bëjmë me kilometra tubacione që kërkojnë procese të vazhdueshme të: pozicionimit dhe shtrimit të tubit; bashkimit të segmenteve; montimit të rakorderive; realizimit të degëzimeve; montimit të saraçineskave; montimit të valvulave; montimit të matësive; lidhjeve në puseta; kontrollit të nyjeve përpara mbulimit të kanalit; përgatitjes së rrjetit për provat e presionit dhe funksionimit.*

*Volumi i punës rritet më tej nga numri i madh i rakorderive dhe elementeve të rrjetit.*

*Në linjën e dërgimit parashikohen Tee gize, fllanxha çeliku, saraçineska dhe valvula të kontrollit/reduktimit të presionit.*

*Këto procese kërkojnë personel me profesion hidraulik dhe nuk mund të realizohen vetëm nga punëtorë të pakualifikuar, pasi cilësia e montimit të lidhjeve ndikon drejtpërdrejt në hermeticitetin dhe funksionimin e rrjetit.*

*Numri prej 8 hidraulikësh argumentohet edhe nga organizimi i punimeve në disa fronte. Një organizim racional lejon krijimin, për shembull, të 4 grupeve me nga 2 hidraulikë, të cilët mund të angazhohen paralelisht në segmente/nënobjekte të ndryshme të rrjetit.*

*Ky organizim është në përputhje me karakterin e objektit, ku linjat kryesore, linjat shpërndarëse dhe nyjet/pusetat ndodhen në zona të ndryshme dhe punimet duhet të zhvillohen paralelisht për të respektuar grafikun.*

*Kështu, numri 8 nuk lidhet vetëm me sasinë e tubave, por me kombinimin e volumit shumë të madh të rrjetit + numrit të rakorderive/pajisjeve + numrit të nënobjekteve + nevojës për disa fronte pune.*

## *5. Karpentierë – 7 (shtatë)*

*Kërkesa për 7 (shtatë) Karpentierë argumentohet nga volumi i konsiderueshëm i punimeve të betonit dhe betonarmesë dhe, në mënyrë të veçantë, nga ndërtimi i depos së re 2,000 m<sup>3</sup>.*

*Ndërtimi i një rezervuari të kësaj natyre kërkon realizimin e elementeve të ndryshme konstruktive – pllakë, mure, soletë, trarë, kolona dhe elemente të tjera – për të cilat procesi i kallëpimit është i lidhur drejtpërdrejt me realizimin e strukturave betonarme.*

*Preventivi i depos përmban 590 m<sup>2</sup> skelë metalike, krahas volumeve të konsiderueshme të armaturës dhe strukturave të betonarmesë.*

*Nevoja për karpentierë nuk kufizohet vetëm te depoja. Në Gorre, për shembull, parashikohen gjithsej mbi 51 m<sup>3</sup> struktura monolite dhe të holla betoni, krahas 7.95 ton armaturë.*

*Në Gramëz Zona nr. 3 parashikohen gjithashtu struktura C16/20, C20/25 dhe 25.92 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite.*

*Në Gramëz Zona nr. 2 parashikohen 26.64 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite, krahas strukturave të tjera të betonit.*

*Në Sukth Vendas parashikohen po ashtu struktura monolite C16/20, C20/25 dhe 12.96 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite.*

*Kjo tregon se proceset e kallëpimit nuk zhvillohen vetëm në një nënobjekt, por përsëriten përgjatë rrjetit.*

*Numri prej 7 karpentierësh lidhet me nevojën për krijimin e një grupi të mjaftueshëm pune për realizimin e kallëpeve të elementeve të depos, ndërkohë që një pjesë e personelit mund të angazhohet në pusetat dhe strukturat betonarme të rrjetit.*

*Kërkesa duhet parë edhe në raport me vazhdimësinë teknologjike:*

*kallëpim → armim → betonim → çmontim kallëpi → kalim në elementin tjetër.*

*Nëse kapaciteti i karpentierëve është i pamjaftueshëm, krijohet vonesë jo vetëm në procesin e kallëpimit, por edhe në punën e hekurkthyesve dhe betonuesve që vijojnë pas tij.*

*Për rrjedhojë, numri 7 argumentohet nga volumi i strukturave betonarme, ndërtimi i depos 2,000 m<sup>3</sup>, përsëritja e strukturave/pusetave në nënobjektet e rrjetit dhe nevoja për ruajtjen e vazhdimësisë së ciklit teknologjik të betonarmesë.*

## *6. Hekurkthyes – 7 (shtatë)*

*Kërkesa për 7 (shtatë) Hekurkthyes mbështetet drejtpërdrejt në sasinë e konsiderueshme të hekurit të betonit të parashikuara në preventiv.*

*Vetëm për ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup> parashikohen: 39 ton hekur betoni Ø6–10 mm; 109 ton hekur betoni Ø>12 mm.*

*Kjo përfaqëson rreth 148 ton armaturë vetëm për këtë nënobjekt.*

*Përpunimi i një sasive të tillë armature përfshin disa procese pune: seleksionimin sipas diametrave, matjen, prerjen, përkuljen, përgatitjen e elementeve, transportin e brendshëm, vendosjen sipas vizatimeve konstruktive, lidhjen dhe kontrollin përpara betonimit.*

*Përveç depos, armatura parashikohet në mënyrë të përsëritur edhe në nënobjektet e rrjeteve.*

*Në Gorre parashikohen 7.95 ton hekur betoni Ø6–10 mm.*

*Në Gramëz Zona nr. 3 parashikohen 5.40 ton.*

*Në Gramëz Zona nr. 2 parashikohen 5.55 ton.*

*Në Sukth Vendas parashikohen 2.70 ton hekur betoni.*

*Pra, edhe vetëm këto nënobjekte të evidentuara tregojnë se sasia e armaturës tejkalon ndjeshëm 148 tonët e depos dhe se punimet e hekurit zhvillohen në disa zona.*

*Kjo ka rëndësi të veçantë për argumentimin e numrit 7. Nuk kemi vetëm një grup që duhet të përpunojë armaturën e rezervuarit; duhet të sigurohet njëkohësisht vazhdimësia e punimeve të armaturës edhe për pusetat dhe strukturat e rrjetit.*

*Numri prej 7 hekurthyesish krijon kapacitet për organizimin e punës në disa procese: një pjesë në përgatitjen/prerjen dhe përkuljen e armaturës dhe pjesa tjetër në montimin dhe lidhjen e saj në strukturë, me mundësi angazhimi paralel edhe në strukturat e rrjetit.*

*Gjithashtu, hekurthyesit janë pjesë e të njëjtit cikël teknologjik me karpentierët dhe betonuesit. Pas përgatitjes së kallëpit duhet të realizohet armimi dhe vetëm pas kontrollit të tij mund të vazhdojë betonimi. Për këtë arsye, mungesa e kapacitetit të mjaftueshëm në hekurthyes do të ndikonte drejtpërdrejt në ritmin e punimeve të betonarmesë.*

*Betonues – 5 (pesë)*

*Kërkesa për 5 betonues lidhet drejtpërdrejt me volumin e konsiderueshëm të punimeve të betonit dhe betonarmesë, veçanërisht me ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>, por edhe me strukturat betonarme që përsëriten përgjatë linjave të ujësjellësit.*

*Preventivi për linjën e dërgimit parashikon, ndër të tjera, 2.00 m<sup>3</sup> struktura monolite betoni C16/20, 28.50 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite C20/25, si dhe beton C20/25 për mbështetjen e rakorderive.*

*Volumi bëhet shumë më i rëndësishëm në nënobjektin e depos së re. Vetëm zëri i transportit të betonit me autobetonierë për këtë nënobjekt është 1,200.50 m<sup>3</sup>, çka evidenton shkallën e lartë të betonimeve që duhet të realizohen.*

*Krahas depos, preventivi parashikon punime betoni dhe betonarmeje në rrjetet shpërndarëse, në pusetat, bazamentet dhe mbështetjet e rakorderive. Pra, betonimi nuk është proces i përqendruar vetëm në një pikë, por përsëritet në disa nënobjekte.*

*Puna e betonuesve përfshin proceset e hedhjes, shpërndarjes, vibrimit, nivelimit, përpunimit të sipërfaqeve dhe trajtimit të betonit pas hedhjes. Në elementet e depos, ku kërkohet realizimi i strukturave ujëmbajtëse, cilësia e betonimit është veçanërisht e rëndësishme, sepse defektet në kompaktim apo vazhdimësinë e betonimit mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe përpërkueshmërinë e strukturës.*

*Numri prej 5 betonuesish krijon një grup funksional pune që mund të përballojë betonimet e elementeve kryesore të depos dhe, sipas nevojës, proceset e betonimit në strukturat e rrjetit. Ky personel duhet të punojë në koordinim të drejtpërdrejtë me karpentierët dhe hekurkthyesit, pasi cikli teknologjik është kallëpim–armim–betonim.*

*Për rrjedhojë, kërkesa për 5 betonues është e lidhur me volumin e lartë të betonit, ndërtimin e rezervuarit 2,000 m<sup>3</sup> dhe praninë e vazhdueshme të strukturave betonarme përgjatë nënobjekteve të rrjetit.*

#### *Saldator – 4 (katër)*

*Kërkesa për 4 saldatorë argumentohet nga prania e punimeve me elemente dhe konstruksione metalike, si dhe nga vetë linja e dërgimit, e cila në preventiv emërtohet si linjë dërgimi nga tubi i çelikut 700 mm drejt depos 2,000 m<sup>3</sup>.*

*Në preventiv evidentohen gjithashtu zëra konkretë për tuba çeliku Ø rreth 200 mm, çka provon se tubacionet metalike janë pjesë reale e punimeve.*

*Në linjën e dërgimit parashikohen edhe fllanxha çeliku DN200 PN40, rakorderi gize, saraçineska dhe pajisje të tjera që kërkojnë punime të kujdesshme montimi dhe përshtatjeje të elementeve metalike.*

*Në depon 2,000 m<sup>3</sup> kemi edhe konstruksione të mirëfillta metalike: 14 ml shkallë inoksi, 108 ml trarë metalikë IPE 160 për ndarje kati, 24 ml trarë IPE 160 për shkallë dhe 106 m<sup>2</sup> dysHEME metalike me zgarë të zinguar.*

*Këto punime kërkojnë prerje, përgatitje, bashkim dhe montim të elementeve metalike, procese për të cilat saldimi është një nga operacionet bazë të realizimit.*

*Numri 4 saldatorë është i argumentueshëm edhe nga nevoja për të mos përqendruar të gjithë punën metalike në një ekip të vetëm. Proceset e montimit të linjave metalike mund të zhvillohen paralelisht me montimin e konstruksioneve metalike të depos. Në këtë kuptim mund të organizohen dy grupe pune me nga dy saldatorë për fronte të ndryshme.*

*Për rrjedhojë, kërkesa lidhet me tubacionet e çelikut, fllanxhat, konstruksionet metalike, shkallët, trarët IPE dhe dysHemetë metalike të parashikuara konkretisht në preventiv.*

#### *Punonjës për Konstruksione Metalike – 2 (dy)*

*Kërkesa për 2 punonjës të specializuar për konstruksione metalike është e lidhur drejtpërdrejt me nënobjektin e depos së re.*

*Preventivi parashikon konkretisht: 14 ml shkallë inoksi me profil “L”; 108 ml trarë metalikë IPE 160 për ndarje kati; 24 ml trarë metalikë IPE 160 për shkallë; 106 m<sup>2</sup> dysHEME metalike me zgarë të zinguar.*

*Këto zëra përfaqësojnë punime specifike të montimit të konstruksioneve metalike dhe kërkojnë personel me njohuri praktike për pozicionimin, montimin, fiksimin, nivelimin dhe bashkimin e profileve dhe elementeve metalike.*

*Ky profil duhet të diferencohet nga saldatori: saldatori realizon kryesisht procesin specialist të saldimit dhe bashkimit, ndërsa punonjësi i konstruksioneve metalike angazhohet në montimin e përgjithshëm të strukturës, pozicionimin e profileve, mbajtjen dhe fiksimin e elementeve, montimin e shkallëve dhe dysHEMEve metalike dhe asistimin gjatë saldimit.*

*Numri prej 2 punonjësish krijon një grup minimal funksional për montimin dhe manovrimin e elementeve metalike dhe është proporcional me zërat e identifikuar në preventiv.*

#### *Elektromekanik – 1 (një)*

*Kërkesa për 1 elektromekanik lidhet me faktin se objekti përmban pajisje dhe sisteme ku komponenti mekanik/hidraulik ndërthuret me komandimin elektrik dhe elektronik.*

*Në depon e re preventivi parashikon kuadër komandimi me ndërprerës dhe fotoelement, kablllo elektrike, priza trefazore dhe pajisje elektronike RTU për komunikim me sistemin SCADA.*

*Në të njëjtën kohë, depoja dhe linjat përmbajnë pajisje hidromekanike, si matës uji induktiv, matës niveli ultrasonik, valvula, saraçineska dhe pajisje të kontrollit të presionit. Në depon 2,000 m<sup>3</sup> parashikohet konkretisht matës uji induktiv DN350 dhe 2 matës niveli ultrasonik.*

*Elektromekaniku është profili që mbulon pikërisht ndërfaqen midis pjesës mekanike dhe sistemit elektrik të pajisjeve: montimin dhe lidhjen e elementeve elektromekanike, kontrollin e furnizimit elektrik, ndërfaqet e pajisjeve, asistencën gjatë provave dhe vënies në punë.*

*Kërkesa për 1 person konsiderohet proporcionale pasi ky profil ka rol të specializuar mbështetës dhe bashkëpunon me elektrikistët, mekanikët dhe specialistët elektronikë/IT.*

#### *Hidroizolues – 4 (katër)*

*Kërkesa për 4 hidroizolues ka një lidhje shumë të fortë dhe të drejtpërdrejtë me preventivin.*

*Bazuar në preventivin e punimeve ka zëra të mirëfilltë hidroizolimi, përfshirë: 1,050 m<sup>2</sup> hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum; 863 m<sup>2</sup> hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa katrama.*

*Për vetë depon e ujit parashikohet një proces edhe më specifik: 683 m<sup>2</sup> hidroizolim i depos me shtresë me bazë Epoxy për ujë të pijshëm, duke përfshirë pastrimin me larje dhe aplikimin e materialit hidroizolues.*

*Përveç kësaj parashikohen: 582 m<sup>2</sup> shtresë primer poliuretani; 582 m<sup>2</sup> dy shtresa poliuretani; 230 ml Waterstop hydro-expance.*

*Këto janë punime që kërkojnë personel të specializuar, sepse cilësia e përgatitjes së sipërfaqes dhe aplikimit të materialit është përcaktuese për papërshkueshmërinë e strukturës.*

*Në një depo uji, hidroizolimi është element funksional i veprës dhe jo thjesht përfundim sipërfaqësor. Për këtë arsye kërkohet grup pune i aftë të realizojë përgatitjen e sipërfaqeve, aplikimin e primerit, shtresave hidroizoluese, trajtimin e fugave dhe zonave të Waterstop-it.*

*Numri 4 hidroizolues mundëson organizimin e një grupi të specializuar për realizimin e sipërfaqeve relativisht të mëdha të parashikuara në preventiv dhe për respektimin e fazave teknologjike të aplikimit.*

*Elektracist – 4 (katër)*

*Kërkesa për 4 elektricistë mbështetet nga një grup i gjerë zërash të instalimeve elektrike dhe tokëzimit.*

*Preventivi për depon përmban: 10 ndriçues fluorescentë; tuba elektrikë; përcjellës PV-500 me seksione 1.5, 2.5 dhe 4 mm<sup>2</sup>; çelësa dhe priza; kuti derivacioni; 12 elektroda tokëzimi; 220 ml përcjellës shirit Zn 30×3 mm; 210 ml përcjellës tokëzimi Cu S=35 mm<sup>2</sup>.*

*Në pjesë të tjera të depon parashikohen gjithashtu 60 ml kabull elektrik 3×2.5 mm<sup>2</sup>, 320 ml tub fleksibël për shtrirje në tokë, kuadër komandimi, 60 ml kabllo XLPE 4×10 mm<sup>2</sup>, priza 32A dhe 100 ml përcjellës mbrojtës bakri S=35 mm<sup>2</sup>.*

*Sistemi SCADA shton më tej instalime elektrike në puseta, ku preventivi evidenton 22 zbarra tokëzimi Cu, 88 morseta bakri për tokëzimin e sistemit rrufepritës, 165 ml përcjellës mbrojtës, 550 ml kabllo bakri TU 3×2.5 mm<sup>2</sup>, 11 panele diellore me kontrollues dhe bateri dhe 11 kuadro elektrikë të pusetave.*

*Pra, kemi procese të ndryshme: ndriçim, instalim kabllosh, kuadro, priza, tokëzim, mbrojtje, furnizim të pajisjeve dhe instalime në puseta.*

*Numri prej 4 elektricistësh argumentohet nga mundësia e organizimit të disa proceseve paralelisht: një grup për instalimet e depon dhe një grup për instalimet e pusetave dhe sistemit SCADA. Për shkak të shtrirjes territoriale të pusetave dhe ndarjes së tyre nga depoja, kjo strukturë shmang që të gjitha punimet elektrike të varen nga një ekip i vetëm.*

*Specialistë IT – 2 (dy)*

*Kërkesa për 2 specialistë IT lidhet drejtpërdrejt me komponentin SCADA të objektit. Në preventivin përmbledhës është parashikuar si nënobjekt i veçantë “Ndërtimi i sistemit SCADA për pusetat e komandimit”, me vlerë 16,547,790.42 lekë pa TVSH.*

*Në depon e re parashikohet një pajisje elektronike memorizuese dhe kontrolluese me modul komunikimi në distancë (RTU), e përshtatshme për komunikim me programin SCADA ekzistues.*

*Preventivi për sistemin SCADA përmban gjithashtu pajisje dhe procese karakteristike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përfshirë kompjuter desktop, ruter interneti,*

modem komunikimi të postit qendror me pajisjet në objekte, program SCADA dhe dhënës niveli piezometrik 4–20 mA.

Ky sistem nuk kërkon vetëm instalim fizik. Ai kërkon konfigurimin dhe integrimin e pajisjeve, rrjetit të komunikimit dhe programit, komunikimin ndërmjet pikave periferike dhe postit qendror, testimin e transmetimit të të dhënave dhe kontrollin e funksionimit të sistemit SCADA.

Për këtë arsye, specialistët IT janë të nevojshëm për proceset e konfigurimit të komunikimit, adresimit dhe lidhjeve të pajisjeve, konfigurimin e ruterëve/modemeve, asistencën në integrimin e RTU-ve dhe SCADA-s dhe testimin e transmetimit e ruajtjes së të dhënave.

Numri prej 2 specialistësh IT argumentohet edhe nga dy nivelet funksionale të sistemit: nga njëra anë pajisjet periferike/RTU dhe komunikimi në terren dhe, nga ana tjetër, konfigurimi dhe kontrolli i postit qendror/programit SCADA. Në fazën e integritetit dhe vënies në punë këto procese duhet të koordinohen dhe testohen së bashku.

Kërkesa për 3 (tre) mekanikë lidhet me volumin dhe shumëllojshmërinë e elementeve mekanike dhe hidromekanike të parashikuara në preventiv, të cilat kërkojnë montim, rregullim, kontroll dhe ndërhyrje teknike gjatë realizimit dhe vënies në punë të rrjetit.

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- ❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njohuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); te vlefshme.

Për mjetet e siguruara me qera, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit.

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

**Shënim:** Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>" në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore **e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kërkohej që operatorët ekonomike t'i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njësi është bazuar tek zërat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkojnë me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe janë përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon çertifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Kërkesa për disponimin e makinerive të mësipërme është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën lineare të objektit, shtrirjen e tij në disa nënobjekte dhe volume të konsiderueshme të gërmimeve, transportit të dherave/materialeve, mbushjeve dhe punimeve të betonit. Preventivi tregon se këto procese zhvillohen në linjat kryesore dhe shpërndarëse të ujësjellësit në Fushë-Kuqe, Thumanë dhe zonat përkatëse, ndaj kërkohej një flotë e diferencuar sipas kapacitetit dhe funksionit.

#### 1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton – 2 copë

Kërkesa për 2 kamionë vetëshkarkues mbi 20 ton lidhet me volumet shumë të larta të transportit të dheut dhe materialeve të ndërtimit. Në disa nënobjekte preventivi parashikon shprehimisht “Transport materiale ndërtimi, dheut me auto deri 10 km”, me volume prej 14,517.74 m<sup>3</sup>, 14,323.52 m<sup>3</sup>, 12,354.80 m<sup>3</sup> dhe 3,668.82 m<sup>3</sup> vetëm në disa segmente.

Kamionët me kapacitet të lartë janë të nevojshëm për transportin masiv të dheut të gërmuar, materialeve të prishjeve, çakëllit dhe materialeve të tjera të mbushjes. Kërkesa për 2 copë mundëson punën paralelisht në dy fronte dhe redukton numrin e cikleve të transportit për volumet kryesore.

#### 2. Kamion vetëshkarkues 10–12 ton – 2 copë

Kamionët e kategorisë 10–12 ton plotësojnë transportin e mjeteve të mëdha në zona ku kushtet e aksesit ose dimensionet e frontit të punës nuk e bëjnë optimal përdorimin e kamionëve mbi 20 ton. Kjo nevojë lidhet me faktin se punimet zhvillohen në rrjete shpërndarëse, rrugë lokale dhe zona të ndryshme ku transporti i materialeve duhet të realizohet sipas karakteristikave të secilit segment. Përveç transportit të dheut, preventivi parashikon volume shumë të larta çakëlli dhe gurësh gurorë, për shembull 7,781.20 m<sup>3</sup> vetëm në linjën kryesore Fushë-Kuqe dhe 4,854.50 m<sup>3</sup> në linjën kryesore Thumanë.

Dy mjete të kësaj kategorie mundësojnë furnizimin e vazhdueshëm të fronteve me materiale mbushëse pa u varur vetëm nga kamionët e tonazhit të madh.

#### 3. Kamion vetëshkarkues 5–10 ton – 1 copë

Kërkesa për 1 kamion 5–10 ton lidhet me transportet me volum më të vogël dhe me zonat ku rrjeti zhvillohet në ambiente të ngushta ose rrugë lokale.

Preventivi përmban jo vetëm volume masive, por edhe punime të shpërndara në pusetat, lidhjet, strukturat e vogla, prishjet dhe rikthimet lokale. Për këto procese një kamion me tonazh të ndërmjetëm është më funksional dhe shmang përdorimin joeficient të kamionëve të mëdhenj.

#### 4. Kamionçina 3.5–5 ton – 2 copë

Kërkesa për 2 kamionçina lidhet me transportin e përditshëm të materialeve, pajisjeve dhe veglave ndërmjet fronteve të ndryshme.

Objekti përmban punime të shumta me tuba, rakorderi, elemente metalike, materiale ndihmëse dhe pajisje të vogla. Për shembull, preventivi përmban në mënyrë të përsëritur tuba çeliku, tuba të galvanizuar dhe rakorderi në nënobjekte të ndryshme.

Dy kamionçina janë të arsyeshme për furnizimin paralel të dy fronteve me materiale dhe pajisje pa angazhuar kamionët vetëshkarkues.

#### 5. Eskavator me zinxhir – 1 copë

Kërkesa për 1 eskavator me zinxhir lidhet kryesisht me punimet më të rënda të gërmimit, terrenet me rezistencë më të lartë dhe gërmimet në shkëmb.

Në linjën kryesore Fushë-Kuqe preventivi parashikon 599 m<sup>3</sup> gërmim shkëmbi të copëtuar me ekskavator 0.5 m<sup>3</sup>, me shkarkim në mjet. Në Thumanë parashikohen edhe 256 m<sup>3</sup> gërmim shkëmbi me ekskavator.

Eskavatori me zinxhir është i përshtatshëm për këto procese për shkak të stabilitetit dhe aftësisë së punës në terrene më të vështira.

#### 6. Eskavator me goma – 2 copë

Ky është një nga kriteret më të mbështetura drejtpërdrejt nga preventivi. Zëri “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m” përsëritet në shumë nënobjekte.

Vetëm disa volume janë: Fushë-Kuqe: 11,378.80 m<sup>3</sup>; Thumanë: 6,940.20 m<sup>3</sup>; Gorre: 9,935.50 m<sup>3</sup>; Gramëz Zona 2: 5,993.90 m<sup>3</sup>; Gramëz Zona 3: 4,041.20 m<sup>3</sup>; Sukth Vendas: 2,400.20 m<sup>3</sup>.

Vetëm këto nënobjekte përmbajnë mbi 40,000 m<sup>3</sup> gërmim me ekskavator me goma. Për këtë arsye, 2 eskavatorë me goma janë të justifikuar nga nevoja për realizimin paralel të gërmimeve në dy fronte të rrjetit.

#### 7. Fadromë me goma – 1 copë

Kërkesa për 1 fadromë lidhet me ngarkimin dhe sistemimin e materialeve në kantier, furnizimin e kamionëve dhe përhapjen paraprake të materialeve të mbushjes.

Preventivi përmban volume të mëdha të zërit “Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”. Për shembull, 11,526.90 m<sup>3</sup> në një nënobjekt, 11,152.60 m<sup>3</sup> në një tjetër dhe 7,935.50 m<sup>3</sup> në Patok.

Fadroma është e lidhur funksionalisht me ngarkimin, grumbullimin dhe përhapjen e këtyre materialeve.

#### 8. Minifadromë – 1 copë

1 minifadromë plotëson fadromën kryesore në zona me hapësira të kufizuara, rrugë lokale, pranë pusetave dhe në segmentet ku një fadromë e madhe nuk mund të operojë me lehtësi.

Duke qenë se rrjeti është linear dhe punimet janë të shpërndara në shumë zona, minifadroma është e nevojshme për lëvizjen lokale të materialit, pastrimin e kanaleve, sistemimin e materialeve rreth pusetave dhe asistimin e proceseve të mbushjes.

Kërkesa për vetëm 1 copë është proporcionale, pasi kjo pajisje ka funksion mbështetës ndaj fadromës dhe ekskavatorëve dhe jo funksion kryesor në të gjithë volumnin e punimeve.

#### *9. Autobetonierë – 2 copë*

*Kërkesa për 2 autobetoniera lidhet drejtpërdrejt me shumëllojshmërinë dhe shpërndarjen e punimeve të betonit dhe betonarmesë.*

*Preventivi parashikon struktura betoni C16/20 dhe C20/25 në pothuajse të gjitha nënobjektet. Për shembull, në Gorre parashikohen 12 m<sup>3</sup> C16/20, 1.50 m<sup>3</sup> C20/25 dhe 38.16 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25. Në Gramëz Zona 2 parashikohen 2 m<sup>3</sup> C16/20, 0.60 m<sup>3</sup> C20/25 dhe 26.64 m<sup>3</sup> C20/25. Në Gramëz Zona 3 evidentohen 8 m<sup>3</sup> C16/20, 0.30 m<sup>3</sup> C20/25 dhe 25.92 m<sup>3</sup> struktura C20/25.*

*Në Sukth Vendas parashikohen gjithashtu 12.96 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25, përveç betonit të klasave të tjera.*

*Për më tepër, në depon e re 2,000 m<sup>3</sup> preventivi parashikon në mënyrë të posaçme 1,200.50 m<sup>3</sup> transport betoni me autobetonierë 10 km, çka e bën nevojën për këtë pajisje veçanërisht të qartë. Kërkesa për 2 autobetoniera mundëson furnizimin e vazhdueshëm me beton të strukturave të depos dhe njëkohësisht të strukturave të vogla betonarme të rrjetit, duke shmangur ndërprerjen e betonimit dhe duke lejuar realizimin e dy fronteve paralelisht.*

#### *10. Fadromë (MT) – 2 copë*

*Kërkesa për 2 fadroma me goma lidhet me volumet shumë të konsiderueshme të punimeve të mbushjes, ngarkimit, zhvendosjes dhe sistemimit të materialeve në kantier. Preventivi përmban në mënyrë të përsëritur zërin “Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”, me volume të larta në disa nënobjekte.*

*Në linjën kryesore të Gramëzit parashikohen 4,085.30 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll dhe gur gurore, si dhe 2,960.10 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 2,340 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm. Në një tjetër nënobjekt parashikohen 11,152.60 m<sup>3</sup> mbushje, 1,649 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 5,595 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm. Ndërsa në një tjetër segment parashikohen 2,734 m<sup>3</sup> mbushje dhe mbi 2,200 m<sup>2</sup> shtresa stabilizanti. Fadromat shërbejnë për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve, grumbullimin, shpërndarjen dhe sistemimin paraprak të çakëllit, stabilizantit dhe materialeve të tjera të mbushjes, si dhe për furnizimin e makinerive të ngjeshjes.*

*Kërkesa për 2 copë lidhet me faktin se punimet zhvillohen në disa zona dhe fronte të ndara; përdorimi paralel i dy fadromave shmang që një makineri e vetme të zhvendoset vazhdimisht ndërmjet fronteve dhe mundëson furnizim të pandërprerë me materiale.*

#### *11. Minifadromë (MT) – 3 copë*

*Kërkesa për 3 minifadroma lidhet me natyrën lineare dhe të shpërndarë të rrjetit të ujësjellësit dhe me faktin se një pjesë e punimeve kryhet në rrugë lokale, pranë banesave, pusetave dhe në zona me hapësira të kufizuara.*

*Preventivi përmban në çdo zonë kombinimin e gërmimeve, mbushjeve, stabilizantit, betonit dhe punimeve të instalimit të tubacioneve. Për shembull, në Gramëz Zona 2 parashikohen 4,771.80 m<sup>3</sup> mbushje, 2,808 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 517 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm. Në Gramëz Zona 3 parashikohen 3,111.50 m<sup>3</sup> mbushje, si dhe shtresa stabilizanti dhe asfalti.*

*Minifadroma është e përshtatshme për sistemimin dhe ngarkimin e materialeve në hapësira ku fadroma e madhe nuk mund të operojë me efektivitet, për pastrimin lokal të fronteve dhe për asistencën gjatë mbushjeve rreth tubacioneve dhe strukturave.*

3 copë mund të argumentohen si tre mjete mbështetëse për tre fronte pune të shpërndara territorialisht. Ky numër nuk del matematikisht nga një zë i vetëm i preventivit, por është proporcional me shtrirjen e objektit dhe organizimin paralel të punimeve.

#### 12. Eskavator me zinxhir + çekic pneumatik – 1 copë

Kjo pajisje ka lidhje të drejtpërdrejtë me punimet e gërmimit në materiale të forta dhe shkëmbore. Në linjën e dërgimit preventivi parashikon 249 m<sup>3</sup> gërmim shkëmbi të copëtuar me ekskavator 0.5 m<sup>3</sup>, me shkarkim në mjet, krahas gërmimeve në tokë të fortë dhe gërmimeve mekanike të kanaleve. Në linjën kryesore Fushë-Kuqe janë evidentuar gjithashtu volume të konsiderueshme gërmimi në shkëmb dhe në toka të kategorive të ndryshme. Prandaj eskavatori me zinxhir, i pajisur me çekic pneumatik/hidraulik për thyerjen e materialeve të forta, është i lidhur drejtpërdrejt me proceset e parashikuara.

Kërkesa për 1 copë është proporcionale, pasi pajisja ka funksion specifik për segmentet ku kushtet e terrenit kërkojnë thyerje ose gërmim më të rëndë dhe nuk është e nevojshme të jetë aktive në të gjitha frontet njëkohësisht.

#### 13. Eskavator me goma (MT) – 2 copë

Ky kriter është ndër më të mbështeturit drejtpërdrejt nga preventivi, sepse zëri “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m” është parashikuar shprehimisht.

Në linjën e dërgimit janë parashikuar 931.60 m<sup>3</sup> gërmim me ekskavator me goma. Në nënobjekte të tjera të objektit volumet e të njëjtit proces arrijnë në mijëra metra kub.

Kërkesa për 2 copë është lidhur nga natyra lineare e objektit dhe nevoja për hapjen njëkohësisht të kanaleve në dy fronte. Dy ekskavatorë reduktojnë kohën e hapjes së traseve dhe sigurojnë vijueshmërinë midis gërmimit, vendosjes së tubacionit dhe rikthimit të shtresave.

#### 14. Minieskavator – 3 copë

Kërkesa për 3 minieskavatorë lidhet me segmentet e rrjetit ku dimensionet e rrugëve, prania e infrastrukturës ekzistuese, banesave, puseta apo lidhjeve të abonentëve e kufizojnë përdorimin e ekskavatorëve të mëdhenj.

Preventivi evidenton një kombinim të gërmimeve mekanike dhe gërmimeve manuale. Në linjën e dërgimit, për shembull, krahas gërmimit mekanik parashikohen 125 m<sup>3</sup> gërmim kanalesh në tokë të zakonshme dhe 170 m<sup>3</sup> në tokë të fortë, gjë që tregon ekzistencën e zonave ku puna kërkon precizion dhe ndërhyrje të kontrolluar.

Minieskavatori shërben pikërisht si mjet ndërmjet gërmimit manual dhe makinerisë së madhe, duke realizuar kanale, zgjerime lokale, punime pranë puseta dhe lidhjeve pa angazhuar ekskavatorët kryesorë. 3 copë lidhet me zhvillimin e disa fronteve të vogla paralelisht në rrjetet shpërndarëse.

#### 15. Grejder (MT) – 1 copë

Kërkesa për 1 grejder lidhet me punimet e profilimit, nivelimit dhe përgatitjes së shtresave para ngjeshjes dhe asfaltimit.

Preventivi përmban volume të mëdha stabilizanti. Në Gramëz, vetëm linja kryesore përmban 2,960.10 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 2,340 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm. Në një tjetër nënobjekt parashikohen 2,894 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 3,376 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm, përpara realizimit të binderit dhe asfaltobetonit.

Në depon e re 2,000 m<sup>3</sup> parashikohen gjithashtu 480 m<sup>3</sup> mbushje, 610 m<sup>2</sup> zhavorr lumi, 750 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 2,270 m<sup>2</sup> stabilizant 15 cm.

Grejderi është i nevojshëm për nivelimin dhe profilimin uniform të bazamentit dhe shtresave granulare, duke siguruar kuotat dhe pjerrësitë e kërkuara para ngjeshjes dhe asfaltimit. Për këtë funksion, 1 copë është e mjaftueshme pasi makina mund të lëvizë në mënyrë të planifikuar nga një segment i përgatitur në tjetrin.

#### 16. Makineri mikrotunelimi horizontal për kalim tubacioni – 1 copë

Preventivi i ujësjellësit zhvillohet në zona ku traseja ndërthuret me rrugë ekzistuese dhe ku parashikohen punime të konsiderueshme të prerjes së asfaltit dhe betonit. Në një nënobjekt parashikohen 4,380 ml prerje asfalti dhe 80 ml prerje rruge betoni, së bashku me vendosjen e sasive të mëdha të tubacioneve PE100 RC me diametra të ndryshëm. Në një tjetër segment parashikohen 2,478 ml prerje asfalti, krahas linjave PE100 RC. Gjithashtu, në një tjetër zonë janë parashikuar 2,462 ml prerje asfalti dhe 8 ml prerje rruge betoni.

Vetëm këto zëra tregojnë se tubacionet kalojnë në një infrastrukturë rrugore ekzistuese dhe se një pjesë e konsiderueshme e rrjetit realizohet në ose pranë akseve të qarkullimit. Në Sukth Vendas evidentohen edhe 999 ml prerje asfalti, krahas gërmimeve mekanike dhe vendosjes së tubacioneve PE100 RC.

Përveç kësaj, linjat kryesore kanë diametra dhe gjatësi të konsiderueshme. Në linjën kryesore të Fushë-Kuqes preventivi parashikon, ndër të tjera, 6,005 ml tub PE100 RC DN200 dhe 3,280 ml tub PE100 RC DN250. Në linjën kryesore të Thumanës parashikohen 2,331 ml DN160, 60 ml DN200 dhe 3,177 ml DN250. Këto gjatësi të mëdha e bëjnë të arsyeshme që gjatë zhvillimit të traseve të paraqiten kalime të akseve rrugore ose pengesave infrastrukturore ku hapja tradicionale e kanalit mund të jetë teknikisht e papërshtatshme ose të shkaktojë ndërprerje të konsiderueshme të qarkullimit.

Në këto raste, mikrotunelimi horizontal shërben për realizimin e kalimit të tubacionit pa hapjen e plotë të sipërfaqes, duke kufizuar prishjen e rrugës, ndërhyrjen në trafik dhe dëmtimin e infrastrukturës ekzistuese. Pajisja mund të përdoret për realizimin e një vrime kalimi nën aksin ekzistues dhe më pas kalimin e tubacionit të ujësjellësit nëpër të.

#### 17. Asfaltoshtruese – 1 copë

Kërkesa për 1 asfaltoshtruese ka mbështetje të qartë dhe të drejtpërdrejtë në preventiv.

Në linjën kryesore Gramëz parashikohen 2,919 m<sup>2</sup> shtresë binderi 6 cm “me makineri” dhe 2,919 m<sup>2</sup> asfaltobeton 4 cm “me makineri”.

Në një tjetër nënobjekt parashikohen 2,808 m<sup>2</sup> binder dhe 2,808 m<sup>2</sup> asfaltobeton, përsëri me makineri. Në një tjetër segment evidentohen nga 2,894 m<sup>2</sup> binder dhe asfaltobeton.

Edhe linja e dërgimit përmban rikthim të shtresave me binder dhe asfaltobeton, si dhe prerje të asfaltit ekzistues.

*Për rrjedhojë, asfaltoshtruesja është e nevojshme për vendosjen mekanike, uniforme dhe me trashësinë e projektuar të shtresave të binderit dhe asfaltobetonit. 1 copë është proporcionale, pasi asfaltimi zhvillohet pas përfundimit të punimeve nëntokësore dhe mund të organizohet progresivisht sipas segmenteve të përfunduara.*

#### *18. Autobitumatriçe me certifikatë për transport lëndë të rrezikshme – 1 copë*

*Pjesa e parë e këtij kriteri, pra nevoja për pajisje të lidhur me punimet bituminoze/asfaltike, mund të argumentohet nga preventivi, sepse ka volume të konsiderueshme binderi dhe asfaltobetonit. Për shembull, vetëm në Gramëz parashikohen 2,919 m<sup>2</sup> binder dhe 2,919 m<sup>2</sup> asfaltobeton. Në segmente të tjera kemi 2,808 m<sup>2</sup> + 2,808 m<sup>2</sup> dhe 2,894 m<sup>2</sup> + 2,894 m<sup>2</sup>.*

*Preventivi përmban edhe punime me materiale bituminoze në hidroizolim; në dokument rezultojnë, ndër të tjera, zëra të tipit “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe katrama”*

#### *19. Autobot Uji – 2 copë*

*Kërkesa për 2 autobote uji lidhet me volumet e mëdha të punimeve të dheut, mbushjeve, stabilizantit dhe shtresave rrugore, të cilat kërkojnë kontrollin e lagështisë së materialit gjatë shtrimit dhe ngjeshjes, si dhe me nevojën për pastrimin dhe mirëmbajtjen e fronteve të punës.*

*Vetëm në depon e re 2,000 m<sup>3</sup> parashikohen 480 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll e gur gurore, 610 m<sup>2</sup> shtresë zhavorri lumi, 750 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 2,270 m<sup>2</sup> stabilizant 15 cm. Në linjat e rrjetit, volumet janë shumë më të mëdha; p.sh. në linjën kryesore të Fushë-Kuqes parashikohen 7,781.20 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll dhe gur gurore, së bashku me mijëra metra katrorë shtresa stabilizanti. Këto janë procese ku sigurimi i lagështisë së përshtatshme është funksionalisht i lidhur me ngjeshjen dhe realizimin korrekt të shtresave.*

*Kërkesa për 2 copë argumentohet edhe nga zhvillimi paralel i punimeve në zona të ndryshme të rrjetit, në mënyrë që furnizimi me ujë për proceset teknologjike dhe pastrimin e kantierit të mos kushtëzohet nga lëvizja e një mjeti të vetëm.*

#### *20. Autobetonierë – 2 copë*

*Kjo kërkesë ka mbështetje shumë të drejtpërdrejtë në preventiv.*

*Në depon e re 2,000 m<sup>3</sup> parashikohet shprehimisht zëri: “Transport betoni me autobetonjere 10.0 km” – 1,200.50 m<sup>3</sup>.*

*Përveç depos, transporti i betonit me autobetonierë përsëritet edhe në nënobjektet e rrjetit. Në Sukth Vendas parashikohen 20.34 m<sup>3</sup>, ndërsa në Gramëz Zona 2 41.81 m<sup>3</sup> transport betoni me autobetonierë. Në Gramëz Zona 3 parashikohen 40.68 m<sup>3</sup> të tjera. Preventivi përmban edhe volume të tjera prej 82.49 m<sup>3</sup>, 108.48 m<sup>3</sup> dhe 110.23 m<sup>3</sup> transport betoni me autobetonierë në nënobjekte të ndryshme.*

*Kërkesa për 2 autobetoniera është proporcionale me këto volume dhe me nevojën për furnizim të pandërprerë të betonit, sidomos gjatë betonimeve që nuk duhet të kenë ndërprerje të panevojshme.*

#### *21. Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5–3.5 m<sup>3</sup>, me targa – 1 copë*

*Kjo pajisje lidhet më shumë me punimet e betonit me volume të vogla dhe të shpërndara në rrjet.*

Preventivi nuk ka vetëm betonime masive. Në linjën e dërgimit, për shembull, parashikohen 2.00 m<sup>3</sup> beton C16/20, 28.50 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25 dhe 3.20 m<sup>3</sup> beton C20/25 për mbështetjen e rakorderive.

Në rrjet ka shumë struktura të vogla betonarme, mbështetje rakorderish, puseta dhe elemente të shpërndara, ku furnizimi me autobetonierë të madhe nuk është gjithmonë zgjidhja më funksionale.

Autobetoniera vetëngarkuese 2.5–3.5 m<sup>3</sup> mund të shërbejë për prodhim dhe transport lokal të sasive të vogla të betonit, sidomos në zona me akses të kufizuar dhe në punime të shpërndara larg frontit kryesor.

#### 22 Autopompë betoni – 1 copë

Kërkesa për 1 autopompë betoni lidhet kryesisht me ndërtimin e depos së re 2,000 m<sup>3</sup>, ku volumi i betonit dhe karakteri strukturor i veprës kërkon vendosjen e betonit në pozicione dhe kuota ku shkarkimi direkt nga autobetoniera nuk është gjithmonë i mundshëm.

Preventivi parashikon për këtë nënobjekt 1,200.50 m<sup>3</sup> transport betoni me autobetonierë, çka tregon qartë shkallën e punimeve të betonit.

Përveç kësaj, objekti përmban struktura monolite dhe struktura të holla C16/20 dhe C20/25 në shumë nënobjekte. Në linjën e dërgimit parashikohen 2 m<sup>3</sup> C16/20 dhe 28.50 m<sup>3</sup> C20/25.

Autopompa shërben për transportin vertikal dhe horizontal të betonit nga autobetoniera deri në pikën e hedhjes, sidomos për mure, pllaka dhe elemente të depos.

#### 23..Fabrikë Betoni e pajisur me leje mjedisore – 1 copë

Kjo kërkesë mbështetet nga volumi shumë i lartë i betonit që duhet furnizuar gjatë kontratës.

Vetëm ndërtimi i depos së re 2,000 m<sup>3</sup> ka zërin 1,200.50 m<sup>3</sup> transport betoni me autobetonierë.

Në nënobjektet e rrjetit ka gjithashtu transporte të betonit prej 20.34 m<sup>3</sup>, 41.81 m<sup>3</sup>, 40.68 m<sup>3</sup>, 82.49 m<sup>3</sup>, 108.48 m<sup>3</sup> dhe 110.23 m<sup>3</sup>, përveç zërave të tjerë të strukturave C16/20 dhe C20/25.

Pra, furnizimi me beton është një proces i rëndësishëm dhe i përsëritur gjatë gjithë kontratës. Fabrika e betonit siguron prodhimin në mënyrë të kontrolluar, vazhdimësinë e furnizimit dhe kapacitetin për realizimin e betonimeve me volum të madh.

#### 24.GPS/Total Station – 1 copë

Kërkesa për 1 pajisje GPS/Total Station lidhet me natyrën lineare, shtrirjen dhe saktësinë gjeometrike që kërkon ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit.

Preventivi parashikon mijëra metra linearë tubacionesh me diametra të ndryshëm. Vetëm në linjën kryesore të Fushë-Kuqes parashikohen 6,005 ml tub PE100 RC DN200 dhe 3,280 ml DN250, përveç diametrave të tjerë. Në linjën kryesore të Thumanës parashikohen 2,331 ml DN160, 60 ml DN200 dhe 3,177 ml DN250.

Në Dukagjin të Ri parashikohen, ndër të tjera, 4,320 ml tub DN200, si dhe mijëra metra tubacione të diametrave të tjerë.

Për një rrjet kaq të gjatë, kontrolli topografik është i nevojshëm për piketimin e aksit të tubacionit, kuotave të gërmimit, pozicionimit të pusetave dhe rakorderive, kontrollin e pjerrësive dhe evidentimin e gjendjes së realizuar.

Kërkesa për 1 copë është proporcionale sepse kjo pajisje përdoret nga stafi topografik në mënyrë të programuar në fazat e piketimit, kontrollit dhe matjeve.

## *25. Betoforma (armaturë/kallëp) – 500 m<sup>2</sup>*

*Kërkesa për 500 m<sup>2</sup> betoforma lidhet me volumet e konsiderueshme të strukturave monolite të betonit dhe betonarmesë që parashikon preventivi. Në linjën e dërgimit janë parashikuar 2.00 m<sup>3</sup> strukturë monolite C16/20 dhe 28.50 m<sup>3</sup> struktura të holla monolite C20/25. Në Adriatik parashikohen 18.00 m<sup>3</sup> C16/20, 0.60 m<sup>3</sup> C20/25 dhe 52.56 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25. Në një tjetër nënobjekt evidentohen 12.00 m<sup>3</sup> C16/20, 1.50 m<sup>3</sup> C20/25 dhe 69.12 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25.*

*Këto struktura kërkojnë kallëpim për mure, pllaka, elemente vertikale dhe horizontale, puseta dhe struktura të tjera betonarme. Disponimi i 500 m<sup>2</sup> betoforma mundëson realizimin e sipërfaqeve të konsiderueshme të kallëpimit pa qenë e nevojshme çmontimi dhe transferimi i vazhdueshëm i të njëjtit sistem nga një element në tjetrin.*

## *26. Matrapik – 2 copë*

*Kërkesa për 2 matrapikë lidhet me punimet e prishjes së betonit, ndërhyrjet në shtresa ekzistuese dhe punimet në materiale të forta.*

*Preventivi parashikon shprehimisht prerje rruge betoni dhe prerje asfalti, për shembull në linjën e dërgimit 8 ml prerje rruge betoni dhe 10 ml prerje asfalti. Në nënobjekte të tjera ka volume shumë më të mëdha ndërhyrjeje në shtresat rrugore; në një segment parashikohen 3,192 ml prerje asfalti.*

*Përveç prerjes me disk, pas delimitimit të zonës së ndërhyrjes është i nevojshëm copëtimi dhe heqja e betonit, materialeve të forta dhe elementeve ekzistuese. Dy matrapikë mundësojnë punë paralelisht në dy fronte dhe përdorimin e tyre në zona ku makineritë e rënda nuk mund të operojnë.*

## *27. Vibrator betoni – 4 copë*

*Kërkesa për 4 vibratorë betoni lidhet drejtpërdrejt me sasinë dhe shpërndarjen e punimeve të betonit.*

*Preventivi përmban në mënyrë të përsëritur struktura monolite C16/20 dhe C20/25. Në Gramëz Zona 2, vetëm një nënobjekt ka 2.00 m<sup>3</sup> C16/20, 0.60 m<sup>3</sup> C20/25 dhe 26.64 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25. Në Adriatik parashikohen gjithsej mbi 70 m<sup>3</sup> struktura të klasave C16/20 dhe C20/25. Në një tjetër nënobjekt rezultojnë 96.12 m<sup>3</sup> struktura të holla C20/25 plus 14 m<sup>3</sup> C16/20.*

*Vibrimi është proces i domosdoshëm gjatë hedhjes së betonit për eliminimin e boshllëqeve, kompaktimin e masës dhe sigurimin e mbushjes së plotë rreth armaturës.*

*Kërkesa për 4 copë është e lidhur me mundësinë e betonimeve në disa fronte dhe me nevojën për pajisje rezervë gjatë betonimeve që nuk duhet të ndërpriten.*

## *28. Tokmak për ngjeshje dheu (kompaktor) – 1 copë*

*Ky kriter është drejtpërdrejt i parashikuar në preventiv.*

*“Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, çdo 30 cm, tokë e zakonshme.”*

*Në një segment ky zë është 1,798.80 m<sup>3</sup>. Në Fushë-Kuqe rezultojnë 1,070.30 m<sup>3</sup> ngjeshje me tokmak elektrik. Në Gramëz Zona 2 parashikohen 426.10 m<sup>3</sup> të të njëjtit proces.*

## *29. Gjenerator – 1 copë*

*Për gjeneratorin nevoja e tij mbështetet nga numri i madh i pajisjeve elektrike që duhet të përdoren në terren: tokmak elektrik, pajisje saldimi, prerje asfalti/betoni, vibratorë betoni dhe pajisje të tjera të punës.*

*Objekti zhvillohet në trase të gjata dhe zona të shpërndara, ku nuk mund të garantohet që çdo front pune të ketë burim të përhershëm energjie elektrike. Gjeneratori shërben si burim autonom energjie për pajisjet portative dhe siguron vijueshmërinë e punimeve.*

### **30. Pompë uji për pastrim – 2 copë**

*Kërkesa për 2 pompa uji lidhet me punimet në kanale, struktura nëntokësore, depo dhe tubacione, si dhe me nevojën për pastrimin e sipërfaqeve dhe largimin e ujit që mund të grumbullohet gjatë punimeve.*

*Preventivi përmban mijëra metra kub gërmime në kanale; në një nënobjekt rezultojnë 14,634 m<sup>3</sup> gërmim mekanik me ekskavator, krahas gërmimeve manuale në toka të ndryshme. Në një tjetër segment rezultojnë 14,484.70 m<sup>3</sup> gërmime mekanike të kanalit.*

*Gjatë realizimit të këtyre kanaleve, pastrimi dhe largimi i ujërave që mund të futen në gërmim është i nevojshëm për përgatitjen e bazamentit dhe montimin e tubacionit. Pompat mund të përdoren edhe për pastrimin e strukturave para betonimit ose aplikimit të materialeve të tjera.*

*Dy copë lidhen me punën në dy fronte të ndryshme.*

### **31. Saldatrice – 2 copë**

*Kërkesa për 2 saldatrice lidhet me punimet e elementeve metalike, tubacioneve prej çeliku dhe konstruksioneve metalike të parashikuara në preventiv.*

*Në objekt janë parashikuar tuba çeliku, elemente metalike, flanxha dhe konstruksione të tjera. Në depon 2,000 m<sup>3</sup>, përveç elementeve hidraulike, preventivi përmban trarë metalikë IPE160, shkallë inoksi dhe elemente të tjera metalike. Në nënobjekte të ndryshme janë parashikuar edhe tuba çeliku rreth Ø200 mm.*

*Puna e saldimit është e nevojshme për përgatitjen, bashkimin, përshtatjen dhe montimin e këtyre elementeve. Kërkesa për 2 copë mundëson zhvillimin e njëkohshëm të punimeve metalike në dy pika të kantierit ose disponimin e një pajisjeje rezervë.*

### **32. Makineri për prerje asfalti – 1 copë**

*Preventivi parashikon zërin “Prerje asfalti me disk, në të dy anët” në një numër shumë të madh segmentesh. Në linjën e dërgimit rezultojnë 10 ml. Në një tjetër nënobjekt rezultojnë 3,192 ml prerje asfalti.*

*Në pjesë të tjera të objektit kemi gjithashtu mijëra metra linearë prerje asfalti, çka tregon se kjo pajisje është e nevojshme gjatë hapjes së kanaleve në rrugë ekzistuese.*

*Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” 3 copë Kërkohe për realizimin e bashkimeve elektrofuzive të tubacioneve dhe rakorderive PE të parashikuara në preventiv. Preventivi përmban një volum shumë të madh tubacionesh PE 100 RC, me diametra të ndryshëm DN/OD 25, 32, 40, 50, 63, 75, 160, 200 dhe 250 mm. Vetëm në linjën kryesore të Thumanës, ndër të tjera, parashikohen 2,331 ml tub PE Ø160 mm dhe 3,177 ml tub PE Ø250 mm. Për këtë arsye, aparatura Elektro Fusion është e nevojshme për kryerjen teknologjikut korrekte dhe të sigurt të*

*bashkimeve të tubave/rakorderive PE. Sasia 3 copë justifikohet nga volumi i lartë dhe shtrirja e punimeve në disa linja/zona të objektit, duke mundësuar fronte pune paralele.*

*Minidumper (mjet teknologjik) 2 copë Preventivi parashikon punime të konsiderueshme gjurmimi në kanale, mbushjeje, transporti dhe manipulimi materiale. Për linjën e Fushë-Kuqes parashikohen, ndër të tjera, 11,378.80 m<sup>3</sup> gjurmim me ekskavator në kanale, si dhe 7,781.20 m<sup>3</sup> mbushjeje me çakëll dhe gur gurore. Minidumperi është i nevojshëm për transportimin dhe shpërndarjen e materialeve përgjatë traseve dhe veçanërisht në segmente ku hapësira e punës është e kufizuar. Dy mjete mundësojnë furnizimin dhe largimin e materialeve në fronte të ndryshme pune pa ndërprerë procesin teknologjik.*

*Aparat saldimi për ngjitje të tubave kokë më kokë (Butt Fusion) 3 copë Është i domosdoshëm për bashkimin me termofuzion kokë më kokë të tubacioneve PE, aty ku teknologjia dhe diametri i tubacionit kërkojnë këtë metodë. Preventivi parashikon kilometra tubacione PE 100 RC. Për shembull, vetëm në linjën Fushë-Kuqe janë parashikuar 6,005 ml tub PE Ø200 mm dhe 3,280 ml tub PE Ø250 mm, krahas diametrave të tjerë. Për shkak të volumit të madh të tubacioneve dhe zhvillimit të punimeve në disa segmente, 3 aparate sigurojnë realizimin paralel të saldimeve dhe respektimin e ritmit të zbatimit të punimeve.*

*Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash 1 copë Preventivi kërkon shprehimisht punime të mbushjes, përhapjes dhe ngjeshjes me makineri, si dhe shtresa stabilizanti. Për linjën kryesore të Thumanës janë parashikuar 4,854.50 m<sup>3</sup> mbushjeje me çakëll/gur gurore të përhapur e ngjeshur me makineri, 4,247.80 m<sup>2</sup> stabilizant 10 cm dhe 2,433 m<sup>2</sup> stabilizant 20 cm. Rruli me vibrim është, për rrjedhojë, i nevojshëm për arritjen e shkallës së kërkuar të ngjeshjes dhe krijimin e një bazamenti të qëndrueshëm pas vendosjes së tubacioneve.*

*Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti 1 copë Preventivi parashikon ndërhyrje dhe rikonstrukcion të shtresave rrugore. Konkretisht parashikohen shtresë binderi 6 cm me makineri dhe shtresë asfaltobetoni 4 cm me makineri, si dhe prerje të asfaltit. Në pjesë të tjera të objektit, vetëm prerja e asfaltit arrin në mijëra metra linearë, p.sh. 5,567 ml në një nga zonat e preventivit. Rruli për asfalt është i nevojshëm për ngjeshjen dhe përfundimin e shtresave asfaltike të rikthyera pas realizimit të rrjetit nëntokësor.*

### **2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve**

**Afati i kryerjes së punimeve është 24 (njetet e kater) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE**

### **2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier për punimet në objekt.**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

**Argumentim:** Kërkesa që Operatori Ekonomik të paraqesë Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier lidhet drejtpërdrejt me kompleksitetin e objektit dhe me faktin se punimet nuk zhvillohen në një kantier të vetëm të përqendruar, por në një numër të madh nënobjektesh dhe zonash të ndryshme territoriale. Preventivi përfshin ndërtimin e linjës së dërgimit drejt depos 2,000 m<sup>3</sup>,

*ndërtimin e depos së re, linjat kryesore të Fushë-Kuqes, Thumanës dhe Gramëzit, si dhe rrjetet shpërndarëse të Patokut, Gorresë, Adriatikut, Dukagjinit të Ri, Bushneshit dhe zonave të tjera.*

*Kjo shtrirje kërkon që operatori të përcaktojë paraprakisht mënyrën e organizimit të fronteve, hyrje-daljet e mjeteve, zonat e depozitimit të materialeve, pozicionimin e makinerive, rrugët e lëvizjes së personelit, zonat e punimeve të rrezikshme dhe mënyrën e koordinimit të disa proceseve që mund të zhvillohen paralelisht.*

*Nevoja për Planin e Sigurisë përforcohet edhe nga vetë zërat e preventivit. Punimet përfshijnë gërmime të thella dhe të gjata për tubacione, prerje të asfaltit dhe betonit, punime me makineri të rënda, rikthim shtresash rrugore, punime betonarmeje, montim tubacionesh me diametra të mëdhenj, konstruksione metalike dhe instalime elektrike. Për shembull, në Fushë-Kuqe vetëm tubacionet DN200 dhe DN250 arrijnë përkatesisht në 6,005 ml dhe 3,280 ml. Në Thumanë parashikohen, ndër të tjera, 2,331 ml DN160 dhe 3,177 ml DN250.*

*Në linjën e dërgimit parashikohen gjithashtu punime me asfalt, beton, prerje rruge dhe montim tubacionesh, pra procese që krijojnë ndërthurje ndërmjet punonjësve, mjeteve të rënda dhe trafikut ekzistues.*

*Ndërtimi i depos së re 2,000 m<sup>3</sup> përfshin punime të rëndësishme strukturore dhe elektromekanike; vetëm transporti i betonit arrin 1,200.50 m<sup>3</sup>, krahas montimit të elementeve metalike, matësve dhe pajisjeve të tjera. Gjithashtu parashikohen instalime elektrike, kuadër komandimi, kablllo dhe pajisje RTU për komunikim me SCADA.*

*Për rrjedhojë, Plani i Sigurisë duhet të trajtojë të paktën organizimin e punimeve në kanale, mbrojtjen ndaj shembjes së skarpateve, lëvizjen e makinerive dhe kamionëve, sinjalizimin e zonave të punës në rrugë, punimet e betonit dhe ngritjes së elementeve, punimet elektrike, përdorimin e pajisjeve të saldimit/prerjes, pajisjet individuale të mbrojtjes dhe procedurat e emergjencës.*

**Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).**

*Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

*Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,*

autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin;

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

**Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.**

**Argumentimi i specifikimeve teknike:** Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

### **Njesia e Prokurimit**